

Viti 2022



RAPORTI VJETOR 2022

GARDA E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Tiranë 2023

Ky raport u përgatit nga Garda e Republikës së Shqipërisë, në kuadër të periudhës 12 mujore të veprimtarisë së këtij institucioni. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e GRSH.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni Gardën e Republikës.

Autor: © Garda e Republikës së Shqipërisë

Adresa: Rr.Elbasanit, pranë pallatit të Brigadave
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2228363 Fax: +355 4 2223156
E-mail: institucioni@garda.gov.al
Faqja zyrtare web: www.garda.gov.al

PËRMBAJTJA:

	TITULLI	FAQE
	Fjala e rastit e Drejtorit të Përgjithshëm.....	3
	Listë Shkurtimesh	5
I	Hyrje	6
	1.1. Baza ligjore e veprimtarisë së GRSH.....	7
	1.2. Akte të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm	9
II	Objektiva të realizuara për vitin 2022	11
III	Treguesit e punës së vitit 2022.....	14
	3.1. Strukturat operacionale.....	14
	3.2. Shërbimet mbështetëse.....	24
IV	Transparenca, Integriteti dhe Bashkëpunimi	33
V	Garda në aspektin social	36
VI	Konkluzione.....	37
VII	Objektiva për vitin 2023	48

FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM DREJTUES MADHOR GRAMOS SAKO

Në përmbyllje të vitit 2022, Garda e Republikës nëpërmjet këtij raporti vjetor synon të ekzaminojë në detaje veprimtarinë e kryer gjatë 365 ditëve të punës së institucionit, sikurse studimin e realizimit të objektivave dhe prioriteteve të paravendosura në krye të vitit paraardhës.

Raporti Vjetor 2022 për veprimtarinë e Gardës së Republikës së Shqipërisë hartohet duke qenë më të vetëkënaqur se një vit më parë nga përmbushja e pritshmërive, nisur edhe nga vitet e vështira që lamë pas, me të cilat i gjithë vendi u përball në këto dy vite të shkuara e që krijuan një realitet të ri përshtatës për çdo individ në botë, sikurse edhe prej realizimit me sukses të implementimit të të gjithë kuadrit ligjor e nënligjor të reformuar, në përafrim me strukturat homologe ndërkombëtare.

Prioriteti kryesor, mbi të cilin mbështetet në themel e gjithë veprimtaria e Gardës së Republikës, mbetet përmbushja e misionit të saj, i cili mbetet i pandryshueshëm në gjendje të fatkeqësisë natyrore apo lufte. Më konkretisht, në nivel zbatueshmërie përfshihet; **garantimi i sigurisë së personaliteteve shtetërore dhe objekteve në ruajtje**, siguria e rrugëkalimeve, me qëllim që të prandalohet në kohë jo vetëm çdo akt i mundshëm me tendenca kriminale, por edhe çdo veprim tjetër sado i dhunshëm apo pengues në lëvizjen normale dhe ushtrimin e detyrës së çdo personaliteti të mbrojtur nga Garda.

Të bësh bilancin e punës së vitit që lamë pas, padyshim është një çështje që kërkon vëmendjen e duhur për të analizuar të gjithë komponentët përbërës të punës sonë, me treguesit pozitivë, por edhe problematikat e hasura. Ky raport pasqyron në mënyrë të përmbledhur këta tregues për secilën strukturë përbërëse të saj, e cila ka specifika të vetat në detyrat që kryen.

Arritjet, së bashku me ato komponentë më të dobët të zinxhirit të sukseseve tona, pasqyrojnë sfidat me të cilat jemi përballur, të cilat në përmbyllje të së gjithës mund të quhen të përmbyllura me sukses. Gjatë vitit 2022, punonjësit e Gardës kanë treguar përkushtim profesional dhe efikasitet të plotë në përmbushje të misionit por njëkohësisht edhe të prioriteteve të vendosura nga institucioni epror, Ministria e Brendshme. Në punën tonë ne mbështetemi në zbatimin e plotë të kuadrit ligjor, tashmë tërësisht të formatuar, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, prioritetet e programit të Qeverisë shqiptare, të Ministrisë së Brendshme, si dhe në programin e vetë institucionit dhe ngjarje të papritura të ndodhura gjatë vitit.

Për të patur sukses është shumë e rëndësishme organizimi i punës dhe shpërndarja e saj. Përpos kryerjes së misionit dhe zbatimit me përpikmëri të akteve ligjore dhe atyre nënligjore, qëllim për ne përbën edhe përfaqësimi sa më natyrshëm, real dhe me dinjitet i punonjësit të këtij shërbimi në komunitet si pjesë përbërëse e tij, krijimi i emrit të respektuar të Institucionit si pjesë e administratës shtetërore dhe përfaqësimi dinjitoz i imazhit të Shqipërisë tek personalitet

e huaja, veçanërisht në eventet e rëndësishme ndërkombëtare që Shqipëria po organizon, mikpret apo është pjesë.

Duke qenë se misioni i Gardës dhe vetë objekti i punës lidhen ngushtësisht me sigurinë e personaliteteve dhe objekteve në ruajtje, edhe raporti i punës së Institucionit fillon me cilësinë e përbushjes së këtyre detyrave që rrjedhin nga misioni i përgjithshëm.

Në faqet e këtij raporti pasqyrohet një përshkrim i detajuar i punës së Gardës së Republikës gjatë vitit 2022. Garda synon të krijojë një raport të hapur komunikimi edhe me publikun. Për këtë arsye, në kapitullin përkatës janë pasqyruar objektivat e zhvillimit të Gardës së Republikës, të cilat do të orientojnë punën tonë edhe në kuadër të përmirësimit të transparencës për vitin 2023.

Viti 2022 do të mbahet mend gjatë në kujtesën e secilit prej nesh. Për herë të parë, Samiti i Bashkimit European u mbajt jashtë kufijve të BE. Garda e Republikës mbajti mbi supe peshën e përgjegjësisë duke treguar kështu se shërbimi i sigurisë së personaliteteve më të larta shtetërore garantohet në të njëjtin nivel me standardet e vendosura europiane. Në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e vendit, të dedikuara për organizimin e Samitit, Garda e Republikës priti, eskortoi dhe siguroi 37 kryetarë të shteteve të Europës, pjesëmarrës në Samitin EU-WB në Tiranë, së bashku me delegacionet përkatëse. Jo vetëm për Bashkimin European, jo vetëm për Shqipërinë, jo vetëm për strukturat shtetërore në tërësi, por edhe për vetë Gardën e Republikës, Samiti shënoi një pikë kyçe dhe tepër domethënëse nga pikëpamja e organizimit të shërbimit të sigurisë, duke treguar sërish se institucioni është në lartësinë e detyrës.

Në mbyllje, dëshiroj t'ju siguroj se Garda e Shqipërisë do vijojë të përbushë misionin e ngarkuar prej ligjit dhe konform tij, në mënyrën më cilësore të mundshme, duke realizuar objektivat dhe pritshmëritë për të perfeksionuar dhe përafruar gjithnjë e më tepër nivelin e shërbimeve me ato të kërkuara në standardet europiane.

Me respekt,

Drejtues Madhor Gramos SAKO

Drejtor i Përgjithshëm

LISTË SHKURTIMESH

Këshilli i Ministrave	KM
Ministria e Brendshme	MB
Ministria për Europën dhe punët e jashtme	MEPJ
Garda e Republikës së Shqipërisë	GRSH
Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit	DPK
Drejtoria për Sigurinë e PLSH	DSPLSH
Drejtoria e sigurisë së organeve të drejtësisë	DSOD
Qendra e Formimit dhe kualifikimit Profesional	QFKP
Personalitete të Larta Shtetërore ¹	PLSH
Personalitete Shtetërore ²	PSH
Objekte të Rëndësisë së Veçantë	ORV
Objekte të përkohshme	OP
Policia e Shtetit	P.SH
Shërbimi informativ shtetëror	SHISH
Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare	DSHQ
Qendra e Shërbimit Mjekësor	QSHM
Struktura e Posaçme Antikorrupsion	SPAK
Byroja Kombëtare e Hetimit	BKH
Komisioni i pavarur i apelimit	KPA
Komisioni i pavarur i kualifikimit	KPK
Operacioni ndërkombëtar i monitorimit	ONM
Objekt i Kohës së Veçantë	OKV
Armë të shkatërrimit në masë	ASHM
Lëndë eksplozive	LE
Vendim i Këshillit të Ministrave	VKM
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	AKSHI
Agjencia e Mbikëqyrjes Policore	AMP

¹ përcaktimi ligjor në nenin 5, pika 13 të ligjit 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”

² përcaktimi ligjor në nenin 5, pika 14 të ligjit 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”

I. HYRJJE

Garda e Republikës u krijua në 24 Qershor 1928. Ajo funksionon në bazë të ligjit 33/2021, datë 16.3.2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”. GRSH është institucion i administratës shtetërore në varësi të Ministrisë për Çështjet e Rendit dhe Sigurisë Publike, e cila raporton dhe përgjigjet drejtpërdrejtë para Ministrit për përmbushjen e misionit.

Misioni i Gardës së Republikës është garantimi i sigurisë së personaliteteve shtetërore dhe objekteve në ruajtje, mision i cili nuk ndryshon në gjendje të fatkeqësisë natyrore, të jashtëzakonshme ose në gjendje lufte.

Punonjësit e GRSH gëzojnë status të veçantë sipas ligjit 33/2021. Përcaktimi i rregullave për organizimin e funksionimin e marrëdhënieve brenda dhe jashtë strukturave të Gardës, përshkrimi i detyrave, përgjegjësi, parimeve, procedura e ecurisë në karrierë, vlerësimi i performancës, rregullat për transferimin, pezullimin, ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, etika e punonjësve të Gardës gjatë dhe jashtë shërbimit, menaxhimi i burimeve njerëzore, rregullat e disiplinës dhe procedurat disiplinore në rast shkeljeje, të drejtën e informimit dhe ankimit, trajtimin e personelit, mbrojtjen e veçantë, e të tjera, parashikohen në dispozitat ligjore të Rregullores së Brendshme të miratuar me Vendimin nr. 777, datë 15.12.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”. Zbatimi i kërkesave të kësaj Rregulloreje krijon kushte për veprime të harmonizuara e standarde të personelit të Gardës.

Në zbatim të kësaj Rregulloreje, drejtuesit hartojnë procedurat standarde të punës për të gjitha funksionet në të gjitha strukturat.

Po ashtu, me synim rregullimin e veprimtarisë së Gardës dhe ligjshmërinë e saj, sikurse edhe për plotësimin e kuadrit ligjor, në zbatim të ligjit 33/2021 janë miratuar një sërë aktesh nënligjore, që lidhen me përcaktimin e personaliteteve që ruan e mbron Garda, trajtimin financiar të punonjësve të Gardës së Republikës, e të tjerë.

Bazuar në ndryshimet e fundit kushtetuese dhe në rëndësinë që institucionet e reja të drejtësisë kanë sa i përket detyrave që kryejnë, bazuar në kërkesën e argumentuar të vetë këtyre institucioneve, Garda e Republikës, në zbatim të Vendimit nr. 507, datë 27.7.2022 “Për një shtesë në vendimin nr. 597, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera, që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”, ruan dhe mbron objektet ku ushtrojnë veprimtarinë Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Ky raport është konceptuar dhe projektuar mbi 4 shtylla kryesore, të cilat kanë të bëjnë me realizimin e objektivave të realizuara për vitin 2022, treguesit e punës për vitin 2022 mbi shërbimet operationale dhe ato mbështetëse, treguesit e punës krahasuar me një vit më parë,

akte të miratuara, si dhe objektiva të vendosura për vitin 2023. Garda e Republikës në sajë të një metodologjie pune të hartuar më parë, ka përpunuar dhe analizuar në këtë raport të dhëna cilësore dhe sasore mbi punën e kryer nga strukturat e institucionit.

1.1.BAZA LIGJORE E VEPRIMTARISË SË GARDËS SË REPUBLIKËS

Nisur nga boshllëqet e konsiderueshme ligjore në drejtim të përcaktimit të qartë të dispozitave ligjore lidhur me organizimin, kryerjen e detyrave, si dhe veprimtarinë e Gardës, të cilat linin shkak për interpretim jo të drejtë të ligjit dhe moszbatimin siç duhet të tij, në vitin 2021 Garda e Republikës, me mbështetjen e Ministrisë së Brendshme, ndërmoi iniciativën për të propozuar reformimin e kuadrin e saj ligjor.

Miratimi i projektligjit të ri të propozuar, u mbështet në nevojën për një reformim rrënjësor në përputhje me strukturat homologe që kanë për detyrë ruajtjen e mbrojtjen e personaliteteve shtetërore, si dhe synimit për përmbushjen e objektivave të përcaktuara në Prioritetet e Ministrisë së Brendshme, në të cilin parashikohet ndërhyrja në ligjin aktual të institucionit.

Në këtë kuadër, në vitin 2021, u miratua ligji i ri “Për Gardën e Republikës” e në zbatim të tij një sërë aktesh nënligjore të implementuara përgjatë vitit 2022, të cilat përsosën arkitekturën ligjore të Gardës.

Konkretisht, institucioni e mbështet veprimtarinë e tij në këto akte ligjore e nënligjore:

- Ligji 33/2021, datë 16.03.2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 777, datë datë 15.12.2021 “Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr 688, datë 18.11.2021 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e Gardës së Republikës” (Ndryshuar me VKM nr.623, datë 28.9.2022);
- VKM nr. 597, datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera, që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë” (Ndryshuar me vendimin nr. 507, datë 27.7.2022);
- VKM nr. 879, datë 27.12.2022 “Për procedurat, rregullat dhe mënyrën e ekuivalentimit të gradave ushtarake me gradat e Gardës së Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 653, datë 3.11.2021 “Për miratimin e paraqitjes, të formës dhe të specifikimeve teknike të gradave, si dhe përcaktimin e simboleve, të uniformës, të shenjave dalluese dhe normave të veshmbathjes së punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 549, datë 29.9.2021 “Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuroparalizuuese, të mjeteve dhe të pajisjeve të tjera kufizuese, për përdorimin e forcës nga Garda e Republikës së Shqipërisë”;
- VKM nr. 548, datë 29.9.2021 “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave të detajuara për trajtimin financiar të familjarëve të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”;

- VKM nr. 652, datë 3.11.2021 “Për përdorimin e mjeteve lëvizëse motorike dhe të mjeteve të blinduara për shërbime të veçanta të Gardës së Republikës së Shqipërisë e përcaktimin e ngjyrës dhe të shenjave dalluese të tyre”;
- Urdhër nr. 296, datë 27.09.2021 i Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e strukturës, organikës dhe përcaktimin e gradave korresponduese për çdo funksion në Gardën e Republikës së Shqipërisë” (ndryshuar me Urdhrin nr. 252, datë 30.12.2022);
- Urdhër nr. 18, datë 24.06.2022 i Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e Tabelës së Organizimit dhe të Pajisjeve të strukturave të Gardës së Republikës”.

Për vitin 2023, në programin e projekt-akteve të parashikuara, kryesisht për plotësimin e akteve nënligjore që rrjedhin prej ligjit 33/2021, dhe që pritet të miratohen janë:

- Projekt-Akt “Për përcaktimin e procedurave të trajtimit me ushqim gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës” – parashikuar për katërmujorin e parë 2023;
- Projekt-Akt “Për përcaktimin e kohëzgjatjes e mbrojtjes së personaliteteve të tjera pas lënies së detyrës dhe kohëzgjatjes së ruajtjes së banesës së personaliteteve të tjera” – parashikuar për katërmujorin e dytë 2023;
- Projekt-Akt “Për përcaktimin e masës ditore të përfitimit dhe procedurën e kompensimit për strehim për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë” - parashikuar për katërmujorin e dytë 2023;
- Projekt-Akt "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për transferimin e punonjësve në struktura të tjera me gradë" – parashikuar për katërmujorin e dytë 2023;
- Projekt-Akt “Për trajtimin e punonjësit me ndihmë financiare në rastet e fatkeqësive në familje, trajtimin e punonjësit me ndihmë financiare në masën e tri pagave mujore, trajtimin e punonjësit me ndihmë të menjëhershme financiare në rast të dëmtimit të rëndë të pronës private për shkak të detyrës” – parashikuar për katërmujorin e tretë 2023;
- Projekt-Akt "Për sigurimin shëndetësor të veçantë, të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë" – parashikuar për katërmujorin e tretë 2023;
- Projekt-Akt "Për trajtimin me kredi të butë të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë" – parashikuar për katërmujorin e tretë 2023;

Veprimtaria e Gardës së Republikës, mbështetet midis të tjerash në:

- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”;

- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar,
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligjin për buxhetin vjetor;
- Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”;
- Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Urdhrin e Ministrit të Brendshëm “Për bashkëveprimin dhe koordinimin e shërbimeve të Gardës së Republikës dhe Policisë së Shtetit për ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore” dhe në Planin e bashkëveprimit përkatës;
- Udhëzimin e përbashkët të bashkëpunimit mes Ministrit të Brendshëm dhe Shërbimit Informativ Shtetëror në funksion të sigurisë së personaliteteve të larta shtetërore;
- Planin e përbashkët të bashkëpunimit ndërmjet strukturave të Gardës së Republikës, DSHQ dhe QSHM në funksion të sigurisë së personaliteteve të larta shtetërore.

1.2. AKTE TË MIRATUARA NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Në funksion të zbatimit të kompetencave ligjore, për sa i përket akteve të miratuara, janë hartuar dhe miratuar në total 17 urdhra administrativë me karakter të përgjithshëm që kanë të bëjnë me çështje të organizimit dhe funksionimit të institucionit, 582 urdhra operacionale së bashku me planet e sigurisë dhe raporte përmbledhëse shërbimi në fund të çdo aktiviteti për të cilat u morën masa sigurie nga Garda.

Sa i takon urdhrave të përgjithshëm administrativë, ndër më të rëndësishmit, rendisim:

1. Urdhër nr. 02, datë 05.01.2022 “Për planifikimin e veprimtarive kryesore të Gardës së Republikës për vitin 2022”;
2. Udhëzim nr. 92, datë 13.01.2022 “Për njohjen dhe zbatimin e programit mbi veprimtarinë e Gardës së Republikës për vitin 2022”;
3. Urdhër nr. 244, datë 11.04.2022 “Për ngritjen e grupeve të punës për përgatitjen e projektakteve në zbatim të ligjit nr.33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”;
4. Urdhër nr. 245, datë 11.04.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të integritetit dhe planit të veprimit 2022-2024 të Gardës së Republikës”;
5. Urdhër nr. 804, datë 30.12.2022 “Për një ndryshim në urdhrin nr.245, datë 11.04.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të integritetit dhe planit të veprimit 2022-2024 të Gardës s Republikës”;
6. Urdhër nr. 181, datë 28.01.2022 “Për miratimin e fushës së përgjegjësisë të strukturave të Gardës së Republikës”;
7. Urdhër nr. 636, datë 13.10.2022 “Për caktimin e personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale në Gardën e Republikës”;
8. Urdhër nr. 637, datë 13.10.2022 “Për caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit në Gardën e Republikës”;

9. Urdhër nr. 148, datë 09.03.2022 “Për hartimin e dokumentacionit në strukturat e Gardës së Republikës”;
10. Urdhër nr. 337, datë 26.05.2022 “Për miratimin e detyrave dhe përgjegjësi të punës për funksionet organike të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse”;
11. Urdhër nr. 342, datë 27.05.2022 “Për ngritjen e komisionit të ekspertizës, për vlerësimin dhe asgjësimin e dokumenteve në Sektorin e Transportit”;
12. Urdhër nr. 674, datë 26.10.2022 “Për miratimin e procedurave standarde të punës, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse në Gardën e Republikës”;
13. Urdhër nr. 681, datë 31.10.2022 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e Gardës së Republikës”;
14. Urdhër nr. 682, datë 31.10.2022 “Për pagat e punonjësve civilë të Gardës së Republikës”;
15. Urdhër nr. 178, datë 28.01.2022 “Për ngritjen e komisionit të ekspertizës”;
16. Urdhër nr.780, datë 12.12.2022 “Për vlerësimin vjetor të punonjësve të Gardës së Republikës”;
17. Urdhër nr. 673, datë 25.10.2022 “Për caktimin e administratorit energjitik në Gardën e Republikës”.

II. OBJEKTIVA TË REALIZUARA PËR VITIN 2022

Si çdo fillim viti, organi epror i Gardës së Republikës, Ministria e Brendshme, harton dhe miraton prioritetet e saj për strukturat e varësisë së bashku me planin e masave.

Konkretisht, në dokumentin e titulluar “Prioritetet në fushën e Çështjeve të Brendshme për vitin 2022” u parashikua se Ministria e Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë, synonin përsosjen e sundimit të ligjit, për të garantuar sigurinë në interes të zhvillimit të vendit dhe shoqërisë. Kjo do të realizohej përmes përbushjes së katër objektivave primare:

- a) thellimit të luftës kundër çdo forme të krimit të organizuar dhe fenomeneve të jashtëligjshme;
- b) kontrollit të plotë të territorit dhe mbrojtjes së mjedisit;
- c) përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve;
- d) mbështetjes me masa konkrete të nismave integruese rajonale e më gjërë.

Aspekt tjetër i rëndësishëm për 2022 do të ishte forcimi i integritetit, profesionalizmi i strukturave dhe përsosja e veprimtarisë së tyre në përputhje të plotë me ligjin dhe në respekt të të drejtave dhe lirive të qytetarëve. Në lidhje me këtë, me urdhër të Ministrit të Brendshëm, Garda e Republikës duhet të hartonte dhe miratonte brenda vitit 2022, Planin e Integritetit institucional. Nga Protokollin i Bashkëpunimit mes Ministrisë së Brendshme dhe Qendrës për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes (CIDS) mbi Projektin “Forcimi i Integritetit në Institucionet e Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, Garda e Republikës, në zbatim të urdhrat të MB, përfitoi asistencë në hartimin e këtij dokumenti sa inovativ, po aq edhe të rëndësishëm. Në Dhjetor, grupi i punës në institucion, përfundoi hartimin e “Planit të Integritetit” dhe u miratua për të shërbyer si një dokument strategjik për periudhën 2023-2025, me qëllim identifikimin e risqeve që çënojnë integritetin institucional, implementimin e masave për shmangien e këtyre risqeve dhe monitorimin e tyre në vijimësi.

Garda e Republikës, krahas objektivave dhe prioriteteve të vendosura për zbatim nga Ministria e Brendshme, vendos objektiva për vetë institucionin mbi bazën e së cilave zhvillohet veprimtaria, përmirësohen treguesit e punës dhe hartohen planet e punës. Ndër objektivat kryesore strategjike të vendosura për vitin 2022 nga Garda mund të përmenden:

- a) Rritja e nivelit të sigurisë së PLSH dhe ORV;
- b) Rritja e performancës së strukturave operacionale, mbështetëse dhe atyre me funksion administrativ;
- c) Përmirësim i programeve të kualifikimit dhe trajnimit;
- d) Forcimi i integritetit.

Me gjithë sfidat e ndryshme që viti solli, jo vetëm për Shqipërinë por edhe për mbarë botën, duke nisur me fillimin e luftës në Ukrainë apo kërcënimet publike të ardhura prej Iranit, mund të thuhet se GRSH ka arritur të përbushë objektivat e paravendosura në mënyrë të kënaqshme,

duke rritur vigjilencën e duke marrë masa konkrete dhe duke i shtuar ato, në drejtim të sigurisë së personaliteteve dhe objekteve në ruajtje. Më konkretisht, mbi realizimin e këtyre objektivave do të flasin Treguesit e Punës në kapitullin vijues.

Sa i përket punës së strukturave që kryejnë shërbime operacionale në drejtim të sigurisë së personaliteteve, të cilat përbëjnë thelbin e detyrave dhe përgjegjësinë kryesore të institucionit, janë realizuar në mënyrë cilësore pa patur momente dobësie. Në këtë drejtim, janë shtuar kontrollet e shërbimeve, janë shpeshuar mësimet treguese në terren përpara zhvillimit të aktiviteteve të personaliteteve duke studiuar terrenin e objektet. Për konkretizimin e cilësisë së shërbimeve, marrim shkas të përmendim protestat e zhvilluara përgjatë vitit të cilat kanë vënë jo pak herë nën trysni punonjësit që qëndrojnë në vijë të parë, apo gjatë zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme lokale në muajin Mars, me aktivitete të shtuara të personaliteteve në rrethin e Shkodrës, Dibrës, Durrësit, Vorës, Rrogozhinës e Lushnjës, shërbime të cilat janë realizuar pa u cënuar asnjë element i sigurisë së personaliteteve. Sfidat më të rëndësishme që lidhej me mbarëvajtjen e sigurisë gjatë zhvillimit të Samitit të BE-BP, po ashtu u realizua me sukses të plotë.

Në funksion të rritjes së performancës së strukturave në tërësi është gjykuar që metodologjia e re e vlerësimit luan një rol kyç. Në këtë aspekt, janë ndërmarrë masat, që edhe gjatë vitit 2022 të kryhet një vlerësim i drejtë, i bazuar në meritokraci dhe mbi të gjitha tërësisht transparent duke u dokumentuar me video, në funksion të mbrojtjes së të drejtës së garantuar për një proces vlerësimi transparent, gjithëpërfshirës dhe proporcional.

Një rol tepër domethënës në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës dhe trajtimit të punonjësve me qëllim motivimin e tyre për të rritur cilësinë e shërbimeve e po ashtu për të vlerësuar punën e tyre të palodhshme, ka luajtur edhe vendimi i Këshillit të Ministrave për rritjen e pagës së punonjësve të nivelit bazë deri tek ai i mesëm me 7%.

Konkretisht:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 623, datë 28.9.2022 “Për një ndryshim në vendimin nr.688, datë 18.11.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë””.

Roli i punonjësit sipas gradave	Grada	Paga mujore për gradë para shtesës në lekë	Paga mujore për gradë pas shtesës në lekë
Për punonjësit e nivelit bazë	Inspektor	50 000	53 500
	Inspektor i dytë	52 000	55 700
	Inspektor i parë	54 500	58 400
Për punonjësit e nivelit të mesëm	Nënkomisar	65 500	70 000
	Komisar	72 000	77 000

Nga rritja e pagave përfituan në total rreth 1210 punonjës.

Me VKM nr. 898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësisve të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës”, Qeveria Shqiptare, shpërbleu punonjësit e Gardës së Republikës me 10.000 dhe 20.000 lekë.

Ndryshimet ligjore të ndodhura, përfshinë gjithashtu sistemin e arsimimit të punonjësve të Gardës. Në nenin 24 të ligjit 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” parashikohet që arsimi të kryhet në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministritë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike. Në këtë drejtim, gjatë vitit u organizuan kurse për kandidatët fitues për t’u punësuar në institucion, por edhe u hartuan programe mësimore të përbashkëta me Akademinë e Sigurisë, duke rinovuar kështu e përshtatur kurrikulat ekzistuese, e në ndonjë rast duke hartuar tërësisht orë mësimore të reja. Përmendim këtu rastin e organizimit të orëve mësimore me kursantët e rinj mbi njohjen e kuadrit ligjor mbi të cilin organizohet dhe funksionon Garda apo për orët e zhvilluara mbi sinjalizuesit dhe kuadrin ligjor përkatës.

Garda e Republikës, nën frymën edhe të institucioneve të tjera të administratës publike, por edhe në kuadër të luftës kundër korrupsionit në rang kombëtar, ka ndërmarrë një sërë hapash formalë dhe praktikë për të luftuar deri në zerimin e këtij fenomeni. Puna në drejtim të luftimit të tij është realizuar, në sajë të reformave makro siç është procesi i Vetëingut, ashtu edhe nëpërmjet reformave mikro siç është reformimi i personelit që shërben në strukturën tonë, proces i cili bëhet një herë në vit, përzgjedhja me shumë kujdes e punonjësve të rinj që zgjidhen për të shërbyer në këtë strukturë etj. Megjithatë, mbetet akoma shumë për të bërë në këtë drejtim.

Hartimi i Planit të Integritetit në Gardën e Republikës së Shqipërisë 2023 – 2025 ka patur për qëllim mbi dhe para së gjithash që ta shndërojë integritetin e institucionit në faktor dominant për mirëfunksionimin e tij, pa lënë pas dore etikën, llogaridhënien dhe transparencën. Ky plan synon të shërbejë në të ardhmen si një nga mjetet kryesore për parandalimin e kërcënimit që vjen nga korrupsionit, kryesisht në fushat me risk më të lartë. Nga ana tjetër, ky dokument do të japë një tablo të qartë se si ndërtohet integriteti dhe se si do të luftohet korrupsioni për ata që nuk janë pjesë e Gardës së Republikës.

Duke qenë të bindur për sfidat e vështira në luftën ndaj korrupsionit, Garda e Republikës së Shqipërisë, me anën e këtij dokumenti do të intensifikojë një hap më lart luftën kundër fenomenit në fjalë, duke respektuar etikën e punonjësit të Gardës.

Vënia në jetë e këtij plani integriteti do ta çojë strukturën e Gardës së Republikës një hap më lart, për të mos thënë pararojë në luftën kundër këtij fenomeni. Ky Plan Integriteti përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Gardës së Republikës dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre.

III. TREGUESIT E PUNËS SË VITIT 2022

Duke qenë se misioni i Gardës dhe vetë objekti i punës lidhen ngushtësisht me sigurinë e personaliteteve dhe objekteve në ruajtje, edhe raporti i punës së Institucionit fillon me cilësinë e përmbushjes së këtyre detyrave që rrjedhin nga misioni i përgjithshëm.

Viti 2022 ka patur të veçantat e veta në aspektin e objektivave e prioriteteve, për ngarkesën e konsiderueshme që e ka karakterizuar dhe performancën cilësore të realizimit të shërbimeve, veçanërisht të atyre të kryera mbi kohën normale të punës e mbi të gjitha të atyre me përgjegjësi të lartë.

3.1. STRUKTURAT OPERACIONALE

3.1.1. DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT është përgjegjëse për hartimin e dokumentacionit të veprimtarive kryesore të Gardës, në përmbushje të detyrës dhe misionit të saj, të urdhrave, udhëzimeve e planeve të ndryshme me karakter operacional, për hartimin e informacioneve dhe analizave periodike dhe vjetore të veprimtarisë së Gardës si dhe për kontrollin e zbatimit të urdhrave dhe udhëzimeve të Drejtorit të Përgjithshëm. Në përbërje të kësaj drejtorie janë këta sektorë:

- a) Sektori i ruajtjes nga LE dhe ASHM;
- b) Sektori i Komunikimit dhe Elektronikës;
- c) Qendra e Aftësimit Profesional në Gardë.

Në funksion të detyrave që rrjedhin nga fusha e përgjegjësisë, kjo Drejtori gjatë vitit 2022 ka përgatitur dokumentacionin përkatës për çdo shërbim sigurie në nivel institucional duke bashkëpunuar dhe organizuar shërbimet me çdo strukturë në Gardë, duke monitoruar më pas në terren se si zbatohen planet e masave në funksion të sigurisë së aktivitetit.

Kështu, gjatë këtij viti u përgatitën dokumente si:

- Plani i veprimtarive kryesore të Gardës për vitin 2022;
- Udhëzimet për njohjen dhe zbatimin e “Planit të veprimtarive kryesore të Gardës për vitin 2022”;
- Informacionet periodike dhe analizat periodike mbi veprimtarinë e institucionit;
- Plani vjetor i stërvitjes për strukturat e Gardës;
- U ripunuan procedurat standarde të punës sipas funksioneve dhe fushës së përgjegjësisë;
- U ripunuan, rifreskuan dokumentat e planëzimit të shërbimit, instruksionet dhe skemat e ruajtjes dhe mbrojtjes së PLSH-ve, ORV-ve dhe objekteve të infrastrukturës së Gardës.

U përgatitën nga DPK 582 urdhra dhe plane operacionale për sigurinë e PLSH-ve të Vendit, 90 urdhra dhe plane sigurie për sigurinë e Seancave Plenare, 78 urdhra dhe plane sigurie për delegacionet e huaja, 44 urdhra dhe plane sigurie për zhvillimin e protestave, 52 urdhra me karakter të përgjithshëm administrativ për mbarëvajtjen e veprimtarisë së shërbimeve të sigurisë, si dhe janë hartuar raportet përmbledhëse të shërbimeve pas çdo aktiviteti të përmbyllur.

Shërbimet e kryera nga strukturat e Gardës e të monitoruara nga DPK:

- Shërbime për sigurinë e Presidentit të Republikës - 312
- Shërbime për sigurinë e Kryetarit të Kuvendit - 249
- Shërbime për sigurinë e Kryeministrit të Vendit - 728
- Shërbime për sigurinë e delegacioneve të huaja - 119
- Shërbime për sigurinë e PSH-ve - 2594
- Shërbime për sigurinë e Mbledhjeve të KM - 25
- Shërbime për sigurinë e Seancave Plenare – 45

A) SEKTORI I RUAJTJES NGA LE DHE ASHM

Ky sektor përgjigjet për sigurinë nga incidentet me lëndë eksplozive dhe armë të shkatërrimit në masë duke kryer kontrole me specialistë xhenerë dhe me qen eksplozivkërkues, duke përdorur aparatura e pajisje të teknologjisë së avancuar. Para çdo aktiviteti ku marrin pjesë personalitete në ruajtje nga Garda, sektori kryen kontrollin xhenero-kimik në objekte, ambiente të brendshme, automjete e të tjerë.

Kontrollet e kryera gjatë vitit nga Sektori:

- Për sigurinë e Presidentit të Republikës – 42 kontrole;
- Për sigurinë e Kryetarit të Kuvendit – 21 kontrole;
- Për sigurinë e Kryeministrit – 292 kontrole
- Për sigurinë e delegacioneve të huaja – 201 kontrole;
- Për sigurinë e PSH-ve – 20 kontrole;
- Për sigurinë e mbledhjeve të Seancave Plenare – 51 kontrole;
- Për sigurinë e seancave të zhvilluara nga KPK dhe KPA – 232 kontrole;
- Për sigurinë në ORV, rrugëkalime, automjete – 671 kontrole;
- Për përforsim shërbimi në ORV – 19 kontrole.

B) SEKTORI I KOMUNIKIMIT DHE ELEKTRONIKËS

Në zbatim të masave të programuara, Sektori i Komunikimit dhe Elektronikës për vitin 2022 programoi si prioritet të punës përmirësimin e sigurisë së sistemeve elektronike, aparatuarave dhe pajisjeve, ruajtjen dhe mbrojtjen e informacionit si dhe zhvillimin e kapaciteteve të sistemit të komunikimit. Disa prej aktiviteteve të ndërmarra në zbatim të këtij objekti ishin:

- Krijimin e Domain-it, mbështetur në strukturën organike të Gardës së Republikës;
- Ngritja e kapacitetit të duhur në Serverat e Gardës për të administruar të gjithë informacionin që prodhohet në rrejtin kompjuterik dhe për t'a arkivuar atë. Në këtë mënyrë, synohet krijimi i një arkive elektronike, për ruajtjen e dokumenteve të hartuara në vijimësi.
- Vendosja e dy serverave të dedikuar Sektorit të Financës së Gardës (një kryesor dhe një tjetër rezervë), ku janë të ruajtura, të administruara dhe të aksesueshme pagat dhe pensionet, inventaret e aktivëve sipas sektorëve dhe shërbimeve. Po kështu, është ndjekur procesi i fiskalizimit.
- Përmirësimi i infrastrukturës së sistemit të kamerave, rrjetit të brendshëm dhe konektimi i tyre me AKSH-in. Sistemet e vëzhgimit dhe sigurisë me kamera në venddislokimin aktual janë zhvilluar duke mbuluar të gjitha zonat e sigurisë.
- Për nevoja të infrastrukturës së rrjetit kompjuterik, si marrja dhe përditësimi i licensave të rrjetit, serverave, PC, instalimit të Antiviruseve etj, me AKSH-in, është realizuar lidhja e drejtpërdrejtë me fibër optike sipas kushteve të sigurisë së diktuar nga ana e tyre, ku nëpërmjet kësaj lidhje marrim dhe shërbim interneti si Back Up (rezervë), duke garantuar mosndërprerje të këtij shërbimi.
- Janë mbështetur në vijimësi strukturat me sisteme dhe pajisje.
- Sistemi i komunikimit në Gardën e Republikës, aktualisht, funksionon si një i vetëm, por me nivele shfrytëzimi, sipas dokumentave të punës. Në sajë të punës së përvitshme, kemi arritur tashmë të kemi të gjitha kapacitetet e nevojshme për programim dhe riprogramim të sistemeve operacionale. Performanca dhe siguria e tij janë testuar dhe në aktivitete të PLSH-ve, PSH-ve apo më gjerë, siç ishte dhe Samiti i datës 06.12.2022.
- Qendra e Komunikimit mobil gjatë këtij viti, sipas planëzimit, ka kryer një numër të konsiderueshëm shërbimesh të rëndësishme për sigurinë e PLSH-ve të vendit dhe të huaja në Tiranë dhe në rrethe. Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, në disa raste qendra e komunikimit mobil i është vënë në dispozicion Policisë së Shtetit për përmbushjen e detyrave të tyre gjatë zhvillimit të aktiviteteve zyrtare.

C) QENDRA E AFTËSIMIT PROFESIONAL NË GARDË

Referuar kuadrit të ri ligjor, struktura përgjegjëse për trajnimin e punonjësve të Gardës gjatë karrierës së tyre në institucion kryhet nga Qendra e Aftësisë Profesionale. Përpos trajnimeve, kjo strukturë bashkëpunon ngushtë me Akademinë e Sigurisë për të hartuar kurrikulat e përbashkëta dhe zhvilluar orë mësimore të ndërthurura gjatë arsimit që kryejnë kandidatët fitues për t'u punësuar në Gardë. Gjithashtu, QAP është struktura në të cilën kryhen stërvitjet e planifikuara të strukturave apo testimet fizike në përmbushje të detyrimit për vlerësimin vjetor të punonjësve. Duke marrë parasysh faktin se trajnimi dhe stërvitja është një komponent kyç në rritjen profesionale të strukturave, QAP-së i është kushtuar një vëmendje e veçantë gjatë këtyre viteve duke bërë kështu të mundur përmirësimin e infrastrukturës së saj nëpërmjet rinovimit të mjediseve të palestrës, ndërtimit të një piste të re vrapi, përmirësimin të kurrikulave ekzistuese, rikonstruksionit të klasave mësimore apo rinovimit të poligonit të qitjes.

Kështu, në muajin shkurt u zhvillua kursi i formimit të përgjithshëm për punonjës të rolit bazë në strukturat e Gardës, në të cilin morën pjesë 52 kursantë.

Po ashtu, gjatë vitit raportues kanë kryer kursin e përgatitjes profesionale:

- 29 punonjës të nivelit të mesëm me gradën “Nënkomisar”;
- 25 punonjës të nivelit bazë me gradën “Inspektor”.

Në QAP u organizuan e u zhvilluan 16 javë stërvitje pesëditore, me punonjës të nivelit bazë, në të cilin kaluan testet me sukses 480 punonjës, nga 494 pjesëmarrës në total. Prej muajit Nëntor është duke u zhvilluar “Kursi i Formimit të Përgjithshëm për punonjës të rolit bazë” në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë, në të cilin marrin pjesë 43 kursantë. Ky kurs do të vijojë edhe në muajt e parë të vitit 2023.

3.1.2. DREJTORIA PËR SIGURINË E PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE përgjigjet për sigurinë fizike të PLSH-ve dhe familjeve të tyre, për sigurinë fizike të PSH-ve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe për sigurinë fizike të personaliteteve të huaja që vizitojnë vendin sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore. Gjithashtu, ka nën përgjegjësi sigurimin e ambienteve të brendshme të objekteve të përkohshme dhe shoqërimin ceremonial me motoçikleta të PLSH-ve të vendit dhe të huaja.

DSPLSH gjatë vitit 2022 ka hartuar 596 plane operacionale në zbatim të veprimtarive të personaliteteve, përkundëjt 516 planeve të hartuara në vitin 2021, ç’ka përkthehet në 80 shërbime sigurie të kryera më tepër në aktivitetet të zhvilluara nga PLSH dhe PSH gjatë 2022.

Konkretisht:

- 355 plane për PLSH-të;
- 167 plane për delegacionet që kanë vizituar vendin;
- 74 plane për shërbim të përforcuar dhe shërbim në Parlament.

Sipas sektorëve për sigurinë fizike të PLSH shërbimet e kryera janë:


1. Për sigurinë e Presidentit të Republikës:
 - a) Shërbime jashtë selie – 179
 - b) Shërbime jashtë rrethit – 154
 - c) Shërbime jashtë shtetit – 13

Në zbatim të nenit 12, pika 1, b) që pas votimit në Parlament, u mor në ruajtje e mbrojtje Presidenti i zgjedhur.

2. Për sigurinë e Kryetarit të Kuvendit:
 - a) Shërbime jashtë selie – 179
 - b) Shërbime jashtë rrethit – 76
 - c) Shërbime jashtë shtetit – 7

3. Për sigurinë e Kryeministrit:
 - a) Shërbime jashtë selie – 286
 - b) Shërbime jashtë rrethit – 236
 - c) Shërbime jashtë shtetit – 6

4. Për sigurinë e PSH-ve:
 - a) Shërbime brenda dhe jashtë Tirane – 3122
 - b) Shërbime jashtë shtetit – 21



DSPLSH krahas detyrave të përhershme në përmbushje të fushës së përgjegjësisë, kryen edhe shërbime sigurie në mbështetje të strukturave të tjera në rastet kur shihet e nevojshme. Në lidhje me këto detyrime, gjatë 2022 janë kryer 720 shërbime të tilla. Këto shërbime kryhen nga sektori i delegacioneve, pjesë përbërëse e drejtorisë.

Sa i përket delegacioneve të huaja që janë siguruar gjatë vitit, mund të përmendim; Presidentin e Republikës së Turqisë, Presidenten e Kosovës; Presidentin e Italisë; Presidentin e Azerbajxhanit; Presidentin e Këshillit të Evropës; Presidenten e Komisionit European; Presidentin e Republikës së Gjermanisë; Kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut; Kryetarin e Dhomës së Deputetëve të Kanadasë; Kryetarin e Dhomës së Deputetëve të Italisë, Kryetarin e Parlamentit të Sllovenisë; Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kryeministrin e Malit të Zi; Kryeministren e Finlandës; Kryeministrin e Spanjës; Kryeministrin e Luksemburgut; Kryeministrin e Republikës së Kosovës; Kryeministrin e Kroacisë. Përveç personaliteteve masa sigurie janë marrë edhe gjatë zhvillimit të takimeve apo eventeve të rëndësishme si: Ministeriali i Ministrave të Transportit, Ministrave të Kulturës dhe Arsimit të vendeve të Rajonit; Delegacioneve pjesëmarrëse në Samitin “Open Ballkan” që u zhvillua në Hotel “Tirana”; PLSH-ve dhe PSH-ve gjatë aktiviteteve që zhvilluan me rastin e 100 vjetorit të marrëdhënieve diplomatike Shqipëri – SHBA; Kryetarëve të Gjykatave Kushtetuese gjatë Konferencës Ndërkombëtare në kuadër të 30 – vjetorit të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë; PLSH-ve dhe PSH-ve gjatë Samitit të zhvilluar nga BE me Ministrat e Brendshëm dhe të Drejtësisë; PLSH-

ve dhe PSH-ve të vendit dhe të Kosovës gjatë zhvillimit të mbledhjes së dy Kuvendeve dhe aktiviteteve të zhvilluara me rastin e 110 vjetorit të Pavarësisë në Tiranë dhe Vlorë; delegacioneve pjesëmarrëse gjatë zhvillimit të Samitit të BE - Ballkanit Perëndimor të zhvilluar në muajin Dhjetor 2022 si dhe personaliteteve të tjera të huaja në rang ministrash dhe Zv/Kryeministrash. Janë kryer 19 shërbime për eskortimin ceremonial të ambasadorëve gjatë dorëzimit të letrave kredenciale tek Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Në total janë kryer 236 shërbime sigurie për delegacionet e huaja përkundrejt 125 të kryera në vitin 2021.

Përgatitja profesionale e fizike e personelit të Sektorit për sigurinë e Delegacioneve është kryer sipas programit mujor miratuar nga DPK, në bazë të plan –tematikut vjetor. Është hartuar dhe kryer programi i përshtatjes me personelin e emëruar rishtas në Drejtori, gjithsej 40 (dyzet) personel (13 niveli i lartë/i mesëm dhe 27 niveli bazë).

Nga data 07 – 18.02.2022 është zhvilluar stërvitja në kushte të veçanta moti e terreni në Rajonin e Dajtit. Gjatë zhvillimit të stërvitjes janë marrë masat dhe zhvilluar temat sipas programit. Më datën 15.02.2022 është kryer trajnim me personelin e Sektorit të Sigurisë Fizike të Kryeministrit për përdorimin e kutive individuale të ndihmës së shpejtë. Janë trajnuar në Akademinë e Sigurisë”, gjithsej 3 personel në “Kursin për leje drejtimi të kategorisë “A”, për motoçikletë. Kanë kryer trajnimin me temë “Kurs për drejtimin të sigurisë të autovecurave të Policisë së Shtetit që shërbejnë për kontrollin e territorit, në Akademinë e Policisë”, 7 (shtatë) punonjës.


Spektori i Ruajtjes së Banesave ka vijuar detyrat rutinë normalisht dhe nuk është vërejtur asnjë problematikë e nuk ka ndodhur asnjë incident gjatë vitit.

3.1.3. DREJTORIA PËR SIGURINË E ORGANEVE TË DREJTËSISË përgjigjet për sigurinë fizike të drejtuesve të organeve të reja të drejtësisë, për ruajtjen e mbrojtjen e godinave ku zhvillon veprimtarinë e seancave gjyqësore KPK dhe KPA, godinën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe për organet e huaja të monitorimit të procesit të Vetingut. Me Vendim nr. 507, datë 27.7.2022 “Për një shtesë në vendimin nr. 597, datë 13.10.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera, që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”, Garda detyrohet të ruajë e mbrojë edhe objektin e SPAK dhe GJKKO.

Gjatë vitit raportues, përveç shërbimeve rutinë për sigurinë fizike të subjekteve që ruhen nga kjo strukturë, DSOD ka kryer:

- shërbim sigurie gjatë zhvillimit të 354 seancave nga KPK dhe KPA;
- 558 shërbime sigurie gjatë zhvillimit të aktiviteteve jashtë objektit të veprimtarisë së përditshme, në Tiranë;
- 1014 shërbime sigurie gjatë zhvillimit të veprimtarive të PSH jashtë Tirane;
- 20 shërbime sigurie gjatë zhvillimit të aktiviteteve jashtë vendit;
- 6 shërbime në mbështetje të strukturave të tjera në Gardë;
- 22 shërbime të përforcuara gjatë zhvillimit të protestave;
- 289 shërbime sigurie në objekte të punës së përditshme të PSH.

Krahasuar me një vit më parë DSOD ka kryer 212 shërbime sigurie më pak.



3.1.4. NJËSIA E PARË përgjigjet për ruajtjen dhe sigurinë e Presidentit të Republikës në objektin e Presidencës, gjatë lëvizjes së tij, në objektet ku akomodohet dhe zhvillon veprimtari, për sigurinë e ish Presidentit, për sigurinë e homologëve të tij kur vizitojnë vendin tonë dhe për sigurinë e Ministrisë përgjegjëse për Punët e Jashtme dhe Evropën.

Gjatë vitit raportues janë kryer 632 shërbime sigurie nga të cilat:

- 58 shërbime të përkohshme në Tiranë;
- 70 shërbime të përkohshme jashtë Tirane;
- 483 shërbime rrugëkalimi në Tiranë;
- 21 shërbime të përforcuara.


Në godinën e Presidencës dhe MEPJ janë kryer shërbime sigurie:

- për 22 delegacione;
- 17 aktivitete për paraqitjen e letrave kredenciale;
- 81 000 mjete të kontrolluara;
- 17 konferenca shtypi;
- 20 intervistime me gazetarë;
- 5038 vizitorë në dy godinat e të tjerë.

3.1.5. NJËSIA E DYTË përgjigjet për ruajtjen dhe sigurinë e Kryeministrit në objektin e Kryeministrisë, gjatë lëvizjes, në objektet ku akomodohet dhe zhvillon veprimtarinë e tij, për sigurinë e ish Kryeministrit, për sigurinë e homologëve të tij kur vizitojnë vendin tonë. Për shkak edhe të aktiviteteve më të shumta në numër, kjo strukturë mbart një peshë tepër të rëndësishme në Gardë.

Gjatë vitit raportues, kjo strukturë ka kryer 1543 shërbime sigurie përkundrejt 1559 të një viti më parë. Konkretisht këto shërbime kategorizohen në:

- Shërbime të përkohshme brenda qytetit të Tiranës – 379;
- Shërbime të përkohshme jashtë Tirane – 396;
- Shërbime për sigurinë e rrugëkalimeve – 691;
- Shërbime të përforcuara gjatë zhvillimit të protestave – 21;
- Shërbime me masa shtesë – 56.




Në objektin e Kryeministrisë janë kryer shërbime sigurie për:

- 47 mbledhje të KM;
- 57 vizita delegacionesh;
- 67 konferenca shtypi;
- 103 aktivitete, takime.

3.1.6. NJËSIA E TRETË përgjigjet për ruajtjen dhe sigurinë e Kryetarit të Kuvendit në Seli, gjatë lëvizjes, në objektet ku akomodohet dhe zhvillon veprimtarinë e tij, për sigurinë e ish Kryetarit të Kuvendit, për sigurinë e homologëve të tij kur vizitojnë vendin tonë, për shërbimet ceremoniale sipas përcaktimeve në ceremonialin shtetëror, për mbarëvajtjen e punës gjatë zhvillimit të Seancave plenare.

Përveç shërbimeve të përhershme nga Njësia e Tretë për vitin 2022 u organizuan, planëzuan dhe kryen këto shërbime të përkohshme:

- Shërbime për sigurim rrugëkalimi për Presidentin e Republikës – 21;
- Shërbime për sigurim rrugëkalimi për Kryeministrin e Vëndit – 125;
- Sigurime të aktiviteteve që ka zhvilluar Kryetari i Kuvendit – 41;
- Përforcime shërbimi në Parlament për seanca plenare – 64;
- Përforcime shërbimi në Selinë e Kuvendit – 49;
- Shërbime ceremoniale për PLSH të vendit dhe të huaja – 101;
- Shërbime sigurie mbështetëse për PLSH dhe PSH e huaja – 138;
- Shërbime të përforcuara për shkak të zhvillimit të protestave – 23;
- Shërbime sigurie gjatë mbledhjes së komisioneve parlamentare – 444.



3.1.7. NJËSIA E KATËRT përgjigjet për ruajtjen dhe sigurinë e objektit të Pallatit të Brigadave dhe objekteve të infrastrukturës së Gardës, Rezidencave Qeveritare të përcaktuara me VKM, duke siguruar edhe PLSH, PSH kur kanë aktivitete e akomodohen në këto objekte.

Gjatë vitit 2022 kjo strukturë ka përmbushur detyrat funksionale sipas treguesve të mëposhtëm:

- 16 shërbime për sigurinë e Presidentit të Republikës;
- 8 shërbime për sigurinë e Kryetarit të Kuvendit;
- 14 shërbime për sigurinë e Kryeministrit;
- 16 shërbime për PSH e huaja;
- ka kryer kontrollin e 4000 pjesëmarrësve që kanë patur akses në objekte gjatë zhvillimit të aktiviteteve;
- ka kryer kontrollin e 300 vizitorëve të ndryshëm.


3.1.8. NJËSIA SPECIALE përgjigjet për kryerjen e shërbimit mbështetes (grup CAT) për sigurinë e PLSH të vendit dhe të huaja gjatë lëvizjeve në eskortë dhe gjatë evakuimit të tyre në rast situatë. Kjo njësi po ashtu është përgjegjëse për kryerjen e shërbimit mbështetes, përforcimin e masave të sigurisë pranë ORV në rastet e përshkallëzimit të situatave, organizimin dhe kryerjen e shërbimit kundërsnajper dhe shërbimit zhytës, si edhe për organizimin e kryerjen e shërbimit të sigurisë gjatë aktiviteteve në kushte të veçanta terreni e moti.

Kjo njësi gjatë vitit 2022 ka realizuar 499 shërbime:

Konkretisht:

- Shërbime me Presidentin e Republikës – 6;
- Shërbime me Kryeministrin – 442;
- Shërbime me PLSH të huaja – 15;
- Shërbime të përforcuara – 20;

- Shërbime në Parlament – 16.



Të dhëna të krahasuara me vitin 2021 për njësinë speciale:



3.1.9. SALLA OPERATIVE

Partneriteti me institucionet e tjera, por edhe me strukturat pjesë përbërëse të Gardës, është i domosdoshëm dhe fillon që me marrjen e informacionit deri në transmetimin e tij. Rol kyç në këtë proces luan **Salla Operative**. Për vitin 2022 ky sektor ka realizuar marrjen e urdhreve, porosive e detyra për zbatim, të cilat janë ndjekur me përgjegjësi dhe zbatuar pa asnjë problem në harkun kohor 12 mujor. Bashkëpunim shumë korrekt kjo strukturë ka patur edhe me strukturat e tjera shtetërore si me Policinë e Shtetit, DSHQ, QSHM, Protokollin e Shtetit, e të tjerë. Për çdo ditë përpilohet përmbledhja në një pasqyrë ditore e të gjithë aktiviteteve të realizuara, brenda e jashtë Tirane, për çdo personalitetet që ruan e mbron Garda dhe i transmetohet për dijeni Drejtorit të Përgjithshëm, duke evidentuar problematikat e hasura apo

çështje për zgjidhje. Salla Operative, monitoron në kohë reale dhe transmeton çdo informacion, duke përdorur pajisje teknologjike të ndryshme në mënyrë që informacioni të transmetohet sa më shpejt dhe saktë drejt burimit përfundimtar.

3.2. SHËRBIMET MBËSHTETËSE

3.2.1. DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE përgjigjet për mbështetjen me transport, logjistikë, shërbim shëndetësor dhe shërbimin e armatimit për të gjithë strukturat e Gardës. Për të analizuar punën e kryer nga kjo drejtori për vitin raportues duhen analizuar komponentët përbërës të drejtorisë në fjalë që janë sektorët e saj.

Përgjatë vitit 2022, DSHM është mbështetur kryesisht në realizimin e detyrave funksionale të secilit sektor, në përmbushjen e nevojave të strukturave për mbarëvajtjen e punës, sikurse edhe në zgjidhjen e situatave të paparashikuara gjatë punës së përditshme.

Në vijim analiza e punës vjetore e secilit sektor, si pjesë integrale e DSHM-së.

A) SEKTORI LOGJISTIK përgjigjet për sigurimin e vazhdueshëm të furnizimit material dhe krijimin e kushteve optimale për punë e shërbim të punonjësve të Gardës. Për një mënyrë sa më efikase të menaxhimit, ky sektor në vetvete ka të ndarë shërbimet që kryen.

- 1. Shërbimi i ushqimit**, ende nuk është tërësisht funksional pasi pritet miratimi i Porjeht-Vendimit të Këshillit të Ministrave mbi trajtimin me ushqim të punonjësve të Gardës. Konkretisht, referuar nenit 48, pika 1, gërma b) të ligjit 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, punonjësit e Gardës për shkak të përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë së lartë në detyrë, përpos pagës mujore bruto, trajtohen edhe me ushqim. Në lidhje me zbatimin e kësaj dispozite, Këshilli i Ministrave duhet të vendosë me anë të një vendimi mbi procedurat e trajtimit të punonjësve me ushqim. Për këtë, që në vitin 2021 është iniciuar përgatitja e projekt-vendimit përkatës për miratim dhe është dërguar në institucionin epror që është MB. Duke qenë se miratimi i kësaj Projekt-VKM-je shoqërohet edhe me efekte financiare, ky projekt-akt ka kaluar për mendim ndër të tjera edhe në Ministrinë e Financave. Përfundimisht, në muajin shtator, pas mendimeve dhe sugjerimeve të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe reflektimit të tyre në projekt-akt, kemi dërguar Projektvendimin e KM “Për përcaktimin e procedurave të trajtimit me ushqim gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të Gardës së Republikës” në Ministrinë e Brendshme. Në datë 20 tetor, nga Specialistët e Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB, janë dërguar me e-mail disa sugjerime të tjera për t’u reflektuar në projektvendim. Në tetor 2022, projektvendimi u dërgua përsëri. Ky projekt-akt, referuar VKM nr. 862, datë 27.12.2022 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023” është parashikuar për miratim në katërmujorin e parë të vitit 2023.

2. **Shërbimi i veshmbathjes** përgjigjet për furnizimin me uniformë të punonjësve të Gardës, në zbatim të dispozitave të ligjit 33/2021, por edhe të VKM nr. 653, datë 3.11.2021 “Për miratimin e paraqitjes, të formës, të specifikimeve teknike të gradave, si dhe përcaktimin e simboleve, të uniformës,...”. Është ndjekur furnizimi i punonjësve me artikuj të uniformës, si dhe janë kompensuar në vlerë monetare për veshjen civile, punonjës të cilët përdorin veshje civile. U kompletuan me uniforma, kursantët në QAP gjatë zhvillimit të kursit. Për vitin 2022, i është siguruar kompletimi me uniformë 1355 punonjësve dhe janë kompensuar me vlerë monetare për veshjen civile 784 punonjës. Plani është realizuar në masën 100% dhe nuk ka prapambetje në këtë drejtim.
3. **Shërbimi i Infrastrukturës** ka ndjekur furnizimin me ujë dhe energji elektrike të ambienteve ku janë akomoduar e kryejnë detyrat punonjësit. Në zbatim të Urdhrit nr. 675, datë 27.10.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës, “Për zbatimin e aktit normativ nr.14, datë 5.10.2022 në strukturat e Gardës së Republikës” dhe Planit të masave nr.1936/2, datë 15.11.2022, DSHM në bashkëpunim me strukturat e tjera të Gardës, morën të gjitha masat paraprake për reduktimin e konsumit të energjisë elektrike në masën 15%, krahasuar me muajin përkatës, të një viti më parë. Deri më tani ky target është realizuar. Ndërkohë, vijon puna për gjetjen zbatim të rregullave të detyrueshme, nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe ushtrimit të kontrolleve të vazhdueshme në këtë drejtim, sipas grafikut mujor të miratuar nga Administratori Energetik. Është ndjekur, pranë drejtorive rajonale të ASHK, hipotekimi i pronave të GRSH, të paregjistruara. Njëkohësisht, problematike për Gardën në këtë drejtim mbetet heqja nga inventari i dy pronave, të cilat nuk përdoren nga Garda ose janë jofunksionale, me qëllim mënjanimin e përdorimit të burimeve njerëzore për ruajtjen e tyre. Në lidhje me këtë problematikë rreth muajit Tetor, kemi dërguar shkresë në MB, në të cilën ju vëmë në dijeni mbi këtë çështje. Janë marrë masat për MNZSH-në, kolaudimi e rimbushja e fikseve të zjarrit. Dy mjete autobot uji, me një personel prej 4 vetash, kanë qënë në gatishmëri gjatë sezonit veror.
4. **Shërbimi i karburantit** ka realizuar furnizimin e pandërprerë të mjeteve me karburant, pa cënuar në asnjë moment kryerjen e detyrave të shërbimit. Gjatë vitit 2022 nuk ka pasur asnjë mjet që ka tejkaluar limitin e përcaktuar në Urdhrin përkatës “Për limitet e kilometrave, karburantit të mjeteve lëvizëse e paisjeve teknike të GR, për vitin 2022”.

B) SEKTORI I TRANSPORTIT është një tjetër sektor kyç në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse në Gardë. Ky sektor përgjigjet për gatishmërinë teknike të mjeteve të shërbimit në Gardë, duke nisur që prej regjistrimit të mjeteve dhe ndjekjes së detyrimeve ligjore për secilën prej tyre, e deri tek vënia në gatishmëri e secilit mjet për kryerjen e shërbimit në çdo ditë të vitit. Veçanërisht, ky sektor vlerësohet për punën shumë cilësore që realizoi gjatë zhvillimit të Samitit BE-WB në dhjetor 2022. Janë përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Brendshme praktikat për vlerësimin për nxjerrje nga përdorimi 6 mjete transporti, të cilat vlerësohen nga autoteknikët se nuk mund të përdoren më dhe janë kompetencë për miratim përfundimtar nga Ministri i Brendshëm.

C) SEKTORI I SHËNDETËSISË përgjigjet për ofrimin e ndihmës shëndetësore për punonjësit e Gardës gjatë kryerjes së shërbimeve. Gjatë vitit raportues ky sektor ka realizuar rreth 3814 vizita mjekësore, stomatologjike e mjekime. Është realizuar sigurimi shëndetësor i punonjësve me mjek e autoambulancë edhe gjatë qitjeve e testimeve fizike, në 65 shërbime për ruajtjen dhe mbrojtjen e PLSH në Tiranë e rrethe apo edhe gjatë stërvitjes dimërore në Dajt, si dhe në shërbimet në ORV gjatë zhvillimit të protestave për çdo rast të mundshëm emergjent. Janë ndjekur rastet e punonjësve të infektuar dhe të dyshuar me COVID. Gjatë vitit janë infektuar 123 punonjës, prej të cilëve 20 janë shtruar në spital dhe fatkeqësisht 4 prej tyre humbën jetën.

D) SEKTORI I PROTOKOLL-ARKIVËS përgjigjet për zbatimin e standardeve për krijimin, ruajtjen, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë dokumentare dhe protokollimin e gjithë korrespondencës hyrëse e dalëse në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Përveç përmbushjes së detyrave funksionale të këtij sektori, gjatë vitit 2022, përfundoi puna për përpunimin e dokumentacionit të vitit 2020. Janë hartuar inventaret e dosjeve të Gardës së Republikës sipas të gjitha kriterëve arkivore të përcaktuara në rregulloren e Ministrisë së Brendshme.

Bazuar në Urdhrin nr. 87, datë 01.6.2022 të Ministrit të Brendshëm “Për zbatimin e vendimit nr. 81, datë 28.01.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, u propozua dhe u dërgua për miratim lista e pjesëmarrësve të Komisionit për Shqyrtimin dhe Asgjësimin e Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror”. Me Urdhër nr. 88, datë 01.06.2022 të Minstrit të Brendshëm “Për krijimin e komisionit për shqyrtimin dhe asgjësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” në Gardën e Republikës”, u krijua komisioni dhe filloi puna për shqyrtimin e dokumentacionit që nevojitej të asgjësohej sipas urdhrin. Me Urdhër nr. 89, datë 01.06.2022 të Ministrit të Brendshëm “Për krijimin e komisionit për shkatërrimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” në Gardën e Republikës” u krijua komisioni për shkatërrimin e dokumentacionit që sipas komisionit të krijuar me urdhër nr. 88, të MB ishte vlerësuar për t’u asgjësuar. Me Vendimin nr. 01s, datë 17.06.2022 të Komisionit të Shqyrtimit dhe Asgjësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror” në Gardën e Republikës vendosi asgjësimin e dokumentacionit të vlerësuar për asgjësim prej vitit 1992-2016. Në këtë kategori, u mënjana asgjësimi i dokumentacionit, i cili është në procese gjyqësore apo që u vlerësua si i rëndësishëm për t’u vijuar të ruhet. Në përmbyllje të procesit, u hartua procesverbali përkatës së bashku me pamjet filmike të procesit të asgjësimit dhe u arkivua në Protokoll-Arkivë. Po ashtu, gjatë këtij viti, u hartua lista konkrete e dokumenteve administrative që hartohen në Gardën e Republikës, së bashku me afatet e tyre të ruajtjes, të përcaktuara me urdhër të MB. Janë filluar praktikatat për pajisje me CSP dhe dërgimi i dokumentacionit të nevojshëm pranë AMP, për 29 punonjës.

Për vitin 2022, puna me dokumentacionin paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Llojet e dokumenteve	Dokumente të hyra (copë)	Dokumente të prodhuara e të dala (copë)
Dokumente të thjeshta zyrtare	1022	2958
Dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”	65	1629
Kërkesa – Ankesa	119	
Shuma	1206	4587
Gjithsej		5793

E) SEKTORI I ARMATIMIT DHE PAJISJEVE përgjigjet për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e armatimit e minicioneve. Gjatë vitit 2022 ka vijuar kompletimin e strukturave me armatim bashkëkohor, duke zëvendësuar armatimin e kalibrit 7.62 mm, me armatim të kalibrit 9 mm. Me automatik 9 mm EVO3, është kompletuar në masën 100 % Drejtoria e Sigurisë së PLSH-ve dhe sektorë të Njësisë së Dytë. Janë realizuar kontrole teknike për funksionimin dhe riparimin e armatimit. Në zbatim të urdhrin nr. 01, datë 18.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës “Për inventarizimin e aktiveve të shërbimit të armatimit në Gardën e Republikës” ka përfunduar inventari i armatimit në Gardë, nga ku nuk kanë rezultuar diferenca. Problemet e mbartura për armatimet e padorëzuara të para viteve 2000, janë në ndjekje.

3.2.2. BURIMET NJERËZORE është sektori që përgjigjet për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës në Gardën e Republikës, sipas dispozitave ligjore dhe atyre nënligjore.

Në drejtim të menaxhimit të resurseve njerëzore dhe karrierës së tyre, gjatë vitit 2022 si vit i impelmentimit të ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, objektiv kryesor i sektorit ka qenë studimi i nevojave për përmirësime në të gjitha strukturat, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe kryerjes me performancë të lartë të shërbimeve. Janë kryer studime lidhur me përmirësimin e raportit ndërmjet shërbimeve mbështetëse dhe atyre operacionale, si dhe të drejtuesve të rangjeve të larta me ata që janë më afër shërbimeve, në favor të këtyre të dytëve. Gjatë 2022 është punuar për pasurimin në dinamikë të dosjeve me kualifikimet apo ecurinë e çdo punonjësi të Gardës, si dhe është pasuruar baza elektronike e të dhënave me informacione shtesë. Aktualisht, për çdo punonjës veç të dhënave personale pasqyrohet edhe ecuria në gradë e karrierë duke krijuar kështu mundësinë të nxjerrim përfundime të bazuara në gjendjen konkrete, për ndjekjen e dinamikës së personelit.

Janë hartuar dhe miratuar procedurat standarde të punës së sektorit, sipas përcaktimeve në ligjin organik dhe rregulloren e Gardës. Për herë të parë, janë standardizuar dokumentet që përdorin apo plotësojnë strukturat dhe punonjësit në raport me burimet njerëzore.

Një tjetër drejtim ku u punua dhe u realizua me sukses, ishte menxhimi i procesit të testimit vjetor, ku burimet njerëzore mbajnë peshën e administrimit të procesit dhe pasqyrimin të rezultateve. Aktualisht, po punojmë për inkorporimin e vlerësimit në testimin fizik, pjesë të databasës së punonjësve. U ripunuan formularët e vlerësimit, duke i përshtatur sipas niveleve dhe metodologjisë bashkëkohore të vlerësimit.

Treguesit kryesor të punës në Sektorin e Burimeve Njerëzore paraqiten si më poshtë:

VITI 2022					
Nr.	Veprimtaria	Niveli i mesëm/i lartë	Niveli bazë	Punonjës administrativ	Gjithsej
1	Konkuruan për pranim në Gardë	13	121	0	134
2	Kurs për formimin e përgjithshëm	29	130	-	159
3	Të pranuar	9	109		118
4	Të liruar	10	84	-	94
5	Kryen kursin për gradë në Akademi	0	0	0	0
6	Konkuruan për gradë	0	0	0	0
7	Fituan gradën e radhës	0	0	0	0
8	Masa ndëshkimore	29	80	-	109
9	Praktika pensioni		89		89
10	Studime jashtë shtetit	10	-	-	10
11	Trajnime jashtë shtetit	1	1	-	2

Gjatë vitit 2022 kanë filluar marrëdhëniet e punës:

Punonjës niveli i lartë	Punonjës niveli i mesëm	Punonjës niveli bazë	Punonjës administrativ	Mosha mesatare	Totali
1	10	110	0	33.5 vjeç	121

Gjatë vitit 2022 kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës:

Gjithsej	Niveli i mesëm dhe i lartë	Niveli bazë	Punonjës administrativ
94	12	82	0

Kryesisht motivacioni i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës gjatë vitit 2022 lidhet me dorëheqjen nga detyra. Por, nuk mungojnë rastet kur si pasojë e masave ndëshkimore të rënda, janë përjashtuar punonjës, duke ndërprerë kështu marrëdhëniet e punës. Konkretisht:

MOTIVACIONI	NUMRI
Me kërkesë	79
Përjashtohet	4

Del në pension	6
Ndërpret kontratën	0
Hiqet nga evidence (kanë humbur jetën)	4
Shkurtime organike	0
Të tjera	1
Totali	94

Sa i përket, shërbimit të psikologjik që funksionon në Gardën e Republikës, pjesë e Sektorit të Burimeve Njerëzore, gjatë vitit 2022, veprimtaria e punës së psikologut është mbështetur në nenin 133, të VKM nr. 777, datë 15.12.2021, “Për miratimin e rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë”, zbatimin e procedurave standarde të punës dhe detyrat funksionale të miratuara, Kodin e Etikës të Psikologut. Veprimtaria kryesore në të cilën është bazuar puna ka qenë kryerja e vlerësimeve psikologjike të punonjësve të pranuar rishtas ose të ripranuar në strukturë, kryesisht të punonjësve të nivelit bazë.

Janë intervistuar, vlerësuar dhe përpiluar raport vlerësimi edhe për punonjës në detyrë të cilët janë referuar nga strukturat përkatëse për shqetësime të natyrës psikologjike të shfaqura gjatë procesit të punës e shërbimit. Në muajin Tetor 2022, gjatë procesit të konkurrimit për përzgjedhjen e kandidatëve, për pranim në kursin e formimit bazë në Akademinë e sigurisë, u zhvillua testimi psikologjik i tyre, me një test psikometrik të administruar në grup.

Me kandidatët që janë shpallur fitues u zhvillua procesi i intervistave psikologjike për të vlerësuar personalitetin dhe gjendjen emocionale të tyre lidhur me përshtatshmërinë e tyre si punonjës të ardhshëm në Gardën e Republikës. Në kuadër të përgatitjes së kurrikulës mësimore për kursin e formimit bazë të kursantëve, jemi angazhuar në përpilimin e temave me përmbajtje psikologjike dhe në vijim me procesin e ligjërimit të këtyre temave.

Ka vijur puna për pasurimin e database të krijuar për mbledhjen e të dhënave psikosociale të punonjësve. Është punuar për njohjen e legjislacionit në fuqi për ushtrimin e detyrës së psikologut si dhe njohjen e akteve ligjore e nënligjore, rregulloret, urdhrat e udhëzimet që normojnë punën në Gardë, veçanërisht në kuadër të ndryshimit të ligjit organik të institucionit dhe akteve nënligjore shoqëruese. Ka vijuar mbajta e kontaktit me drejtuesit e strukturave, për evidentimin e problemeve psiko-sociale të punonjësve që mund të kenë nevojë për ndihmë apo këshillim. Ju është kërkuar bashkëpunim për evidentimin e veçorive të personalitetit të individëve nëpër struktura në interes të përmirësimit të punës. Ju është ofruar gatishmëria për ndihmë dhe për këshillim në gjetjen e formave dhe metodave që do të përmirësonin aspekte të punës. Kontakti me ta është i vijueshëm.

3.2.3. SEKTORI I BUXHET-FINANCËS përbën një tjetër sektor të rëndësishëm në Gardë, por edhe për çdo institucion në tërësi. Buxhet-Financa përgjigjet për zbatimin e rregullave të menaxhimit finaciar, si dhe për administrimin e pasurisë së Gardës së Republikës.

Për vitin 2022 realizimi i buxhetit për Programin Garda e Republikës paraqitet në shifrën 99.4%.

I analizuar më hollësisht, sipas artikujve, rezulton si më poshtë:

- Artikulli 6000000 “Paga, shpërblime dhe shpenzime të tjera personeli” paraqitet me një realizim në masën 99.3 %.
- Artikulli 6010000 “Kontributet për Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” paraqitet me një realizim në masën 99,5 %.
- Artikulli 6020000 “Mallra dhe shërbime të tjera” paraqitet me një realizim në masën 100 %.
- Artikulli 6060000 “Transferta për buxhetet familiare dhe individët” paraqitet me një realizim në masën 99,9 %.
- Artikulli 231 ”Shpenzime për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara” paraqitet me një realizim në masën 99,7 %.

Për periudhën janar – dhjetor 2022 nga Programi Garda e Republikës janë krijuar të ardhura në masën 648.182 lekë, të gjitha nga dhënia me qira e objekteve. Është kryer inventarizimi i pasurisë së Gardës së Republikës, nga ku nuk rezultuan diferenca. Nuk ka asnjë lloj detyrimi monetar ndaj punonjësve deri në datën 31.12.2022.

Me VKM nr.623, datë 28.9.2022 “Për një ndryshim në Vendimin nr.688, datë 18.11.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë” u rritën pagat e Gardës së Republikës mesatarisht me 7% për 5 grada, gjithsej 1210 punonjës garde ose 84% e efektivit.

- a) Grada Inspektor 7% (3.500 lekë), e përfituan këtë rritje page 787 punonjës;
- b) Grada Inspektor i dytë 7.12% (3.700 lekë), e përfituan këtë rritje page 212 punonjës;
- c) Grada Inspektor i Parë 7.16% (3.900 lekë), e përfituan këtë rritje page 2 punonjës;
- d) Grada Nënkomisar 6.87% (4.500 lekë), dhe e përfituan këtë rritje page 97 punonjës;
- e) Grada Komisar 6.94% (5.000 lekë), e përfituan këtë rritje page 112 punonjës.

Në zbatim të VKM nr.898, datë 29.12.2022 “Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zhdukjen e impaktit të krizës”, të gjithë punonjësit e Gardës së Republikës përfituan nga Qeveria Shqiptare nën kujdesin e Kryeministrit ndihmë financiare për zbutjen e impaktit të krizës gjithsej 1349 punonjës, nga të cilët 1333 punonjës përfituan nga 10.000 lekë, ndërsa 16 punonjës përfituan nga 20.000 lekë.

3.2.4. SEKTORI I INFORMIMIT TË BRENDSHËM përgjigjet për monitorimin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore nga strukturat dhe punonjësit e Gardës duke grumbulluar, përpunuar, verifikuar dhe dokumentuar informacione për rastet e cënimit të pastërtisë së figurës së punonjësit të Gardës. Gjatë vitit 2022, ka vijuar bashkëpunimi me struktura të tjera ligjzbatuese si Policia e Shtetit, AISM, ngushtësisht me AMP, e të tjerë. Ky sektor, bazuar në

ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” është caktuar përgjegjës për raportime të mundshme për rastet korruptive, të cilat nuk janë evidentuar në asnjë rast gjatë vitit. Në zbatim të detyrave funksionale, sektori ka kryer verifikime bazuar në planin e tij të veprimtarive, sikurse edhe mbi indicie apo raste të paparashikuara. Konkretisht, për rastet e shkeljes së etikës së punonjësit janë konstatuar 13 punonjës të cilët janë ndëshkuar disiplinarisht për shkelje të lehta. Po ashtu, pas kryerjes së hetimeve, me propozimin e punonjësve të strukturës dhe miratim të autoritetit kompetent, janë ndëshkuar me masën “vërejtje” 4 punonjës, me masën “vërejtje me paralajmërim” 8 punonjës, me masën “mbajtje e pagës në masën e dy ditëve të punës” 3 punonjës, dhe me masën “shtyrje e afatit të gradimit deri në dy vite” 3 punonjës. Në bashkëpunim me komisaritet e policive vendore, janë proceduar penalisht punonjës, për të cilët ka patur dyshime për kryerje të veprave apo kundërvatjeve penale, për 3 prej tyre. Po ashtu, pas nisjes dhe përfundimit të hetimit disiplinor janë përjashtuar nga Garda e Republikës 2 punonjës për shkelje të rënda të integritetit të institucionit.

3.2.5. LIGJSHMËRIA është parimi themelor e funksionimit të të gjitha strukturave në Gardën e Republikës. Duke marrë shkas nga ndryshimet e 100% të arkitekturës ligjore të institucionit, vëmendja kryesore e Kabinetit është fokusuar në implementimin e tërësisë së kuadrit të ri ligjor në çdo element përbërës të punës së Gardës, duke filluar me hartimin e bazës ligjore për çdo dokument të prodhuar nga strukturat, në zhvillimin e mësimave me natyrë interpretuese për secilin nivel punonjësish, e deri në formulimin e dokumenteve nga më të thjeshtat të cilat i referohen akteve nënligjore në zbatim të ligjit 33/2021. Me ndryshimet e reja organike dhe strukturore të ndodhura pas miratimit të ligjit, lindi domosdoshmëri riorganizimi i punonjësve në struktura të Gardës, duke sjellë po ashtu edhe shkurtime të funksioneve. Nisur nga ky fakt, u vu re një shtim i proceseve gjyqësore me karakter administrativ të cilat iu shtuan proceseve të mbartura. Në këtë perspektivë gjatë vitit 2022, Garda është palë në procese gjyqësore siç pasqyrohen në vijim:

Gjatë vitit 2022, janë zhvilluar 24 procese gjyqësore, me palë Gardën e Republikës së Shqipërisë, të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

- a) 7 janë në proces në Gjykatën e Shkallës së Parë, që kategorizohen:
 - i. 1 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës
 - ii. 1 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës (Dhoma Civile)
 - iii. 1 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Dhoma Civile)
 - iv. 4 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- b) 11 procese në Gjykatën e Administrative të Apelit, Tiranë
- c) 1 proces në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, gjykim mbi bazë aktesh në dhomë këshillimi pa praninë e palëve.

Në Gjykimin në Shkallë të Parë nga Garda e Republikës së Shqipërisë:

- a) Janë fituar gjithësej 7 procese, nga të cilët 2 janë ankimuar nga pala tjetër në Gjykatën e Apelit, ndërsa 5 të tjera të paankimuara janë mbyllur që në gjykimin në shkallë të parë, i cili ka marrë formë të prerë.

- b) Është humbur 1 proces, vendim me të cilin nuk kemi qenë dakord dhe kemi ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Administrative të Apelit Tiranë.
- c) Është vendosur pranimi pjesërisht i 8 kërkesë padive kundër Gardës. Edhe për këto vendime kemi ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, për pjesën e vendimit në të cilin është pranuar kërkesë padia.

Në zbatim të Nenit 409 të Kodit të Procedurës Civile dhe Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 26.05.2022 “Për përcaktimin e rregullave për heqjen dorë nga rekursët e depozituara nga administrata shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave të pashqyrtuara nga Gjykata e Lartë, për disa çështje me natyrë civile dhe administrative”, nën mbikëqyrjen dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme është depozituar kërkesa për heqjen dorë nga rekursi për 10 çështje në Gjykatën e Lartë të cilat përfshiheshin, për 3 prej të cilave është pranuar heqja dorë ja që pëfshiheshin në rastet e përshkruara në Udhëzimin e sipërcituar. Në bashkëpunim me sektorë të ndryshëm në Gardën e Republikës, janë hartuar dokumentet përkatëse në zbatim të dispozitave ligjore e nënligjore që normojnë punën në Gardë. Konkretisht, për:

- a) 16 masa disiplinore;
- b) 78 lirime;
- c) 2 masa disiplinore “përjashtim nga Garda e Republikës”;
- d) 19 praktika për trajtim me ndihmë ekonomike;
- e) 5 Projekt - Vendime të Këshillit të Ministrave;
- f) 2 Projekt - Urdhra të Ministrit të Brendshëm;
- g) 7 Urdhra të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës;
- h) 2 shkresa dretjuar Ministrisë së Brendshme;
- i) 6 procedura prokurimi;
- j) 11 procedura prokurimi me vlerë të vogël;
- k) 16 minikontrata;
- l) 24 kontrata;
- m) 17 procedura të ekzekutimit të detyrimeve përmbartimore.

3.2.6. SEKTORI I PROKURIMEVE përgjigjet për mirëadministrimin e fondeve buxhetore të vëna në dispozicion të Gardës, nëpërmjet procedurave transparente dhe ligjore. Gjatë vitit raportues janë realizuar të gjitha procedurat e parashikuara të prokurimeve. Konkretisht:

- a) Janë zhvilluar 6 procedura prokurimi me formën e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” & “Procedurë e hapur”;
- b) Janë zhvilluar 12 (dymbëdhjetë) procedura prokurimi me formën e prokurimit “Blerje me vlera të vogla”;
- c) Janë lidhur 26 kontrata.

3.2.7. SEKTORI I ANALIZËS përgjigjet për marrjen, grumbullimin, evidentimin, përpunimin dhe analizimin e informacioneve në lidhje me akte të mundshme kriminale e terroriste ndaj PLSH, PSH, dhe ORV. Gjatë vitit 2022 sektori ka bashkëpunuar ngushtë me

SHISH, Policinë e Shtetit si dhe duke marrë informacione nga burime të ndryshme në lidhje me kërcënime të ndryshme që çenojnë sigurinë. Konkretisht, janë përgatitur 210 relacione paraprake mbi analizën e veprimtarisë së aktiviteteve të PLSH dhe PSH, 350 relacione përfundimtare pas përfundimit të aktiviteteve dhe 40 studime mbi sigurinë e banesave të PLSH dhe ambienteve ku ata zhvillojnë veprimtari.

IV. TRANSPARENCA, INTEGRITETI DHE BASHKËPUNIMI

PARIMIT TË TRANSPARENCËS, si një nga parimet bazë të administratës publike, i kushtohet vëmendje e veçantë në Gardën e Republikës, pavarësisht faktit se veprimtaria e institucionit nuk lidhet ngushtë me ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta për qytetarët. Transparenca, ashtu siç përdoret në shkencat shoqërore dhe në kontekstin shoqëror përgjithësisht nënkupton të qenët i hapur, zhvillimin e komunikimit me publikun dhe dhënien e përgjegjësisë. Pikërisht, marrëdhënia me publikun reflekton një mënyrë efektive për të garantuar dhe rritur besimin e tij në Gardën e Republikës, si një institucion ligjzbatues.

Garda ka përmbushur në çdo rast brenda afateve detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, dhe nga miratimi i Programit të Transparencës, i cili herëpashere rishikohet në varësi të udhëzimeve dhe direktivave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Në përmbushje të detyrimit ligjor, periodikisht kryhet dhe plotësimi i regjistrit të kërkesave e përgjigjeve, duke u publikuar në faqen zyrtare www.garda.gov.al, në rubrikën Programi i Transparencës. Kryesisht, rruga e ndjekur për të dërguar një kërkesë për informacion në institucion ka qenë nëpërmjet postës elektronike zyrtare institucioni@garda.gov.al. Gjatë vitit 2022, në Gardën e Republikës, kanë mbërritur 42 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar brenda afateve ligjore. Sa i përket kategorisë së informacionit të kërkuar, më së shumti qytetarët kanë shprehur interesim mbi procedurat e punësimit në Gardë. Në 3 raste janë dërguar kërkesa për informacion nga subjekte në cilësinë e gazetarëve dhe mediave që përfaqësojnë, në 1 rast në cilësinë e një avokati, në rastet e tjera subjektet janë paraqitur në cilësinë e qytetarëve. 1 kërkesë për informacion është deleguar për kompetencë trajtimi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, së cilës Garda i është përgjigjur brenda afatit dhjetëditor të parashikuar në ligj.

Në funksion të transparencës, Garda e Republikës ka të ndërtuar prej shumë vitesh faqen zyrtare garda.gov.al, e cila përditësohet me informacione të ndryshme, duke nisur që prej kuadrit ligjor mbi të cilin funksionon institucioni, që prej aktiviteteve të ndryshme që kryhen nga Garda, apo edhe për informacione të dobishme siç janë rekrutimet e punonjësve dhe fazat e zhvillimit të tyre. Faqja e webit shërben në Gardë si alternativa parësore për rritjen e transparencës në mënyrë domethënëse në sy të publikut. Ajo mundëson qasje në kohë reale me informacionin e dëshiruar, duke shtuar këtu edhe adresën zyrtare elektronike institucioni@garda.gov.al në dispozicion të publikut. Rikonceptimi me një dizajn të ri dhe rifreskimi i faqes zyrtare është një objektiv i vendosur për vitin 2023 për t’u përmbushur.

INTEGRITETI konsiderohet tërësia e një sërë parimesh morale si; drejtësia, ndershmëria dhe sinqeriteti, dëshira për të bërë gjënë e duhur dhe pritje e dëshiruar për rezultatet e tyre. Integriteti

është themeli i çdo shteti dhe përbën kushtin bazë për një administratë të efektshme dhe të konsoliduar.

Pasojat e korrupsionit prekin sferën personale, atë institucionale dhe akoma më gjerë edhe atë politike. Punonjësit e administratës duke abuzuar për përfitime personale bëjnë që korrupsioni të jetë shumëdimensional dhe të shfaqet në format nga më të ndryshmet. Korrupsioni e gërryen shoqërinë e një vendi deri në ato përmasa saqë arrin që të bëhet shumë i rrezikshëm edhe për stabilitetin e një vendi. Në këtë kontekst, lufta ndaj këtij fenomeni merr një rëndësi të dorës së parë. Korrupsioni nuk është një nga format e vetme të shkeljes së integritetit. Forma të tjera të shkeljes së integritetit përfshijnë, por nuk janë të limituara në:

- a) Përvetësim, shpërdorim / devijim të fondeve publike;
- b) Trajtimi i qytetarëve / klientëve në mënyrë të pabarabartë apo të padrejtë;
- c) Kërkesat dhe procedurat e tepërta administrative;
- d) Mosrespektimi i procedurave / respektimi i kërkesave ligjore;
- e) Neglizhenca.

Rëndësi të veçantë, për Gardën e Republikës, merr njohja me detaje e risqeve, të cilat shoqërojnë punën e përditshme institucionale dhe pasi të jenë evidentuar këto risqe shumë i rëndësishëm është vlerësimi i tyre. Një vlerësim i drejtë i risqeve do të bënte që të ndërtoheshin strategjitë dhe planet e duhura për zbutjen dhe eliminimin e tyre, duke arritur në këtë mënyrë qëllimin final, atë të rritjes së integritetit të institucionit të Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e Gardës së Republikës në këtë kuadër lidhen me:

- ✓ miratimin dhe zbatimin e politikave të prointegritetit, të cilat materializohen me miratimin e dokumenteve si udhëzuesi i sjelljes apo plani i integritetit;
- ✓ mbikëqyrjen dhe vlerësimin e realizimit të aktiviteteve të institucionit për parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit, kundrejt përmbushjes së objektivave institucionale të integritetit dhe politikave të prointegritetit, të miratuara për këtë qëllim. Rezultatet e vlerësimit i raportohen autoritetit më të lartë ligjzbatues në Gardën e Republikës, i cili përkon me funksionin organik të Drejtorit të Përgjithshëm sipas ligjit 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”;
- ✓ kryerjen e vazhdueshme të aktiviteteve në funksion të përmirësimit dhe forcimit të integritetit të Gardës së Republikës dhe sistemit të menaxhimit të integritetit.

Hartimi i Planit të Integritetit, si dokument strategjik i hartuar në vitin 2022, parashikohet të luajë një rol thelbësor në mbarëvajtjen e luftës kundër korrupsionit në nivel institucional, por edhe në nivel strukturash, që janë pjesë përbërëse e Gardës. Objektivi i Planit të Integritetit është të sigurojë një funksionim efikas dhe efektiv. Qëllimi i Planit të Integritetit nuk është zgjidhja e rasteve individuale të korrupsionit, por krijimi i mekanizmave që do të eliminojnë rrethanat dhe do të ulin rreziqet e korrupsionit dhe veprimeve joetike apo joprofessionale në të gjitha fushat e funksionimit të institucionit. Një objektiv specifik i Planit të Integritetit është

edhe rritja e ndërgjegjësimit që prej nivelit të punonjësve menaxherialë e deri tek ai bazë, për efektet e dëmshme të korrupsionit në mënyrë që të arrihet “zero tolerancë ndaj korrupsionit”.

Konkretisht, ky plan synon:

- a) Përmirësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit në institucion, që ka për qëllim sigurimin e respektimit të kërkesave ligjore, procedurale, kuadrit të brendshëm rregullator, si dhe binjakëzimin me standardet ndërkombëtare homologe në fushën e sigurisë. Ky sistem do të jetë funksional nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve njerëzore të institucionit në të gjitha nivelet për antikorrupsionin efektiv dhe krijimit të bashkëpronësisë për procesin në tërësi, për zhvillimin e zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit, për të gjithë punonjësit e institucionit;
- b) Forcimin e llogaridhënies publike dhe transparencës në Gardën e Republikës, për të siguruar rritjen e besueshmërisë publike në qeverisje dhe në performancën e integritetit të sektorit publik;
- c) Forcimin e rezistencës institucionale ndaj çënimeve të integritetit, përmes përmirësimit të kontroleve operacionale në fushat e funksionit të Gardës së Republikës dhe proceset e punës me risk korrupsioni;
- d) Planifikimin e menaxhimit të riskut të integritetit në Gardën e Republikës, me fokus në fushat me risk më të lartë të çënimit të integritetit, duke synuar integrimin e këtij procesi në kulturën institucionale.

Plani i Integritetit dhe Plani i Veprimit vjen si rezultat i punës disamujore të grupit të punës të ngritur për këtë qëllim. Ky grup pune kishte si qëllim primar identifikimin e fushave apo proceseve të punës më të ekspozuara ndaj risqeve të korrupsionit dhe paligjshmërive të llojeve të tjera. Rezultati i punës intensive u materializua në konkretizimin e këtyre risqeve dhe gjetjen e mekanizmave adekuate për parandalimin dhe eliminimin e tyre.

Dokumenti u hartua në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit, miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, nr. 334, datë 07.10.2020 “*Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore*”, dokument i cili i është referuar Standardeve ISO 31000 dhe 31010, të përshtatura për analizën e riskut të integritetit, gjithashtu dhe duke shfrytëzuar metodat dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Konkretizimi i kësaj pune voluminoze vjen nëpërmjet hartimit dhe miratimit të Planit të Integritetit për Gardën e Republikës, proces pune ky që kaloi në disa faza. Në fazën përfundimtare, në dhjetor 2022 u miratuar dhe gjatë vitit 2023 pritet të implemtohet dhe të monitorohen rezultatet e pritshme konkrete.

BASHKËPUNIMI ka qenë kurdoherë një faktor kyç për përmbushjen e misionit të Gardës, sikurse edhe për realizimin e objektivave të saj. Jo vetëm për shkak të detyrimeve ligjore, të cilat sanksionojnë bashkëpunimin me Gardën dhe strukturave të tjera, por Garda e ka trajtuar si një filozofi në drejtim të mirëfunksionimit dhe mirëmenaxhimit institucional. Bashkëpunimi përfshin atë të brendshëm që nënkupton ndërveprimin e strukturave me njëra-tjetrën dhe

gjithashtu bashkëpunimin e jashtëm apo të njohur si ndërinstitucional, në forcimin e marrëdhënieve institucionale dy apo shumë palëshe. Ky i fundit ka treguar frytet e tij sidomos në rastin e organizimit të eventit historik siç ishte ai i organizimit të Samitit të BE në Shqipërisë. Gjatë organizimit të eventit, Garda e Republikës, në mungesë të kapaciteteve të burimeve njerëzore por edhe të ayre logjistike për t'ua përballuar e vetme eksortimin e 40 delegacioneve, po jo vetëm të tyre, iu dretjua me kërkesa zyrtare institucioneve të ndryshme për t'i ofruar asistencën e nevojshme, të cilat ia ofruan ndihmën duke përmbushur pjesën më të madhe të kërkesave. Në këtë rast, u pa edhe njëherë e u provua bashkëpunimi i shkëlqyer ndërinstitucional me Policinë e Shtetit, me Ministrinë e Mbrojtjes, me Protokollin e Shtetit, me Bashkinë e Tiranës, me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me DSHQ e të tjerë. Në bashkëpunim me Protokollin e Shtetit, arritëm të realizonim në mënyrë të suksesshme dhe profesionale dy brifingjeve të njëpasnjëshme mbi mast e sigurisë të ndërmarra në Samit; njërin me ambasadorët në Shqipëri të vendeve pjesëmarrëse në Samit dhe me stafin e sigurisë së këtyre vendeve. Pas përfundimit me sukses, Garda gjeti rastin t'i falenderonte zyrtarisht të gjitha strukturat që u kujdesën për të ofruar asistencë të pakursyer për përmbushjen me sukses të të gjithë misionit.

Vëmendje do t'i kushtohet forcimit të këtyre bashkëpunimeve dhe lidhjes së marrëdhënieve të reja të bashkëpunimit edhe gjatë vitit 2023, të cilat vlerësohen si pika nevralgjike që kontribuojnë në suksesin e institucionit.

V. GARDA NË ASPEKTIN SOCIAL

Personeli që mbron Personalitetet e Larta Shtetërore shpesh konsiderohet si zinxhiri kryesor i sigurisë së tyre. Njerëzit që marrin përsipër të kryejnë këto detyra shihen gjerësisht si njerëz gjakftohtë, pa shprehje të shumta emocionale, duke krijuar shpesh edhe stereotipe të gabuara në drejtim të imazhit të tyre. Por, punonjësit e Gardës jo pak herë kanë arritur të mundin këto stereotipe duke treguar se janë socialë e mbi të gjitha me shpirt human.

Garda e Republikës, si çdo vit tjetër, edhe gjatë 2022, u sensibilizua duke dhuruar gjak për njerëzit në nevojë në datat 20-21 Shtator. Në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, shumë punonjës të Gardës shprehën vullnetin dhe dëshirën për të dhuruar gjak duke u solidarizuar me këtë nismë. Pas thirrjes të çdo punonjësi, i cili ishte në kushte shëndetësore të përshtatshme, për t'iu bashkuar nismës humanitare për të mbështetur njerëzit në nevojë për gjak dhe veçanërisht fëmijët talasemikë, të shumtë shprehën dëshirën për t'iu bashkuar nismës. Solidariteti dhe tradita e Institucionit për dhurimin rregullisht të gjakut do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Tetori, apo siç njihet gjerësisht Tetori Rozë për shkak të kauzës së trajtuar, është caktuar si muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit në mbarë botën, për të rritur vëmendjen dhe sensibilizimin, zbulimin e hershëm, trajtimin, si dhe kujdesin paliativ të kësaj sëmundjeje.

Fushata sensibilizuese organizohen çdo vit, nëpërmjet të cilave synohet shpërndarja e informacionit në lidhje me shëndetin e gjirit, si rritja e ndërgjegjësimit për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit të gratë dhe vajzat në të gjithë globin. Mesazhi i përzgjedhur si moto për 2022 ishte VRAPO PËR JETËN!

Në kuadër të kësaj nisme, Sektori i Shëndetësisë në Gardë ndërmori një sërë iniciativash për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e punonjëseve në Gardën e Republikës, një ndër të cilat ishte organizimi i takimeve për ndarjen e informacioneve përkatëse për parandalimin, ekzaminimet konkrete, konstatimin e hershëm të simptomave dhe trajtimin e tyre.

Po ashtu, u shpërndanë broshura me informacione të thelluara mbi kancerin e gjirit dhe mënyrën konkrete të vetëkontrollit të simptomave që kjo sëmundje shfaq. Në respekt edhe të simbolikës që Tetori Rozë mbart, u vendosën fjongot rozë, të cilat shoqëruan veshjet e secilës përgjatë muajit.

Në bashkëpunim me Poliklinikën e Specialiteteve Nr. 3 është bërë planifikimi për kryerjen e mamografisë për punonjëset e moshës mbi 40 vjec, bashkëpunim i cili është i trashëguar që prej vitit të kaluar.

Nën frymën e aspektit social, kanë qenë të shumta rastet kur punonjësit kanë kontribuar vullnetarisht për t'iu ardhur në ndihmë kolegëve në rastet kur kanë patur nevojë duke u bërë të gjithë bashkë për të një të mirë të përbashkët. Ky është një aspekt që na bën të ndjehemi krenarë për frymën empatike që ekziston mes nesh.

VI. KONKLUZIONE

Gjatë vitit 2022, strukturat e Gardës kanë përballuar me sukses kryerjen e detyrave të sigurisë me gjithë sfidat që duhet thënë se nuk kanë munguar as këtë vit. Mjafton të përmendim këtu kërcënimet publike ndërkombëtare në drejtim të PLSH të vendit apo mbarëvajtjen e sigurisë së një eventit gjigand siç ishte ai i Samitit BE-WB. Për këtë, GRSH ka hartuar plane të veçanta për shtimin e masave të sigurisë.

Në përmbushjen me sukses të misionit të përcaktuar me ligj, bashkëpunimi mes strukturave, por edhe më gjerë, ka qenë faktor dominues. Krahasuar me të njëjtën periudhë analizuese të vitit 2021, treguesit e performancës të punonjësve të Gardës kanë rritje të efektivitetit përpos edhe të sasisë së tyre. Për shkak edhe të protestave të shoqërisë civile e subjekteve politike strukturat e Gardës kanë kaluar disa herë në shërbime të përforcuara.

Po ashtu, rritja e pagave apo ndihmesa financiare për përballimin e krizës globale, luajtën një rol motivues në radhët e punonjësve. Miratimi i VKM nr. 507, datë 27.7.2022 për të siguruar objektet e SPAK dhe GJKKO, me kërkesë të drejtuesve të këtyre institucioneve, është një përgjegjësi e shtuar dhe vlerësim për strukturat e Gardës, duke dëshmuar sërish se janë një hallkë e rëndësishme në zinxhirin e sigurisë kombëtare.

Sukses tjetër ishte edhe mbarëvatja e sigurisë dhe eskortimi i delegacioneve pjesëmarrëse në Samitin e Bashkimit Europian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, i cili duhet thënë se përbënte një nga organizmet më të rëndësishme e historike të shtetit shqiptar. Realizimi me sukses të plotë na bën të ndjehemi krenarë dhe vlerësimi nga strukturat e prore na motivon për të vijuar për të bërë më të mirën në drejtim të sigurisë.

Nisur nga fakti i rëndësishëm se Shqipëria po realizon gjithnjë e më tepër objektivin e të qenit pjesë e familjes së Bashkimit Europian, para Gardës së Republikës shtrohet si i domosdoshëm kontributi e roli i saj në krijimin e një imazhi të një shteti me siguri të lartë. Përpos këtij fakti rezulton po ashtu i rëndësishëm roli i Shqipërisë në arenën ndërkombëtare si vend i renditur krahas atyre në luftën kundër terrorizmit. Këtë e vlerësojmë si shtysë për të bërë të mundur përmirësimin e vazhdueshëm të masave të sigurisë në zbulimin dhe parandalimin e çdo rreziku të mundshëm që mund të ndërmerret ndaj PLSH-ve apo çdo objekti që kemi në ruajtje në mënyrë të tillë që të ruajmë klimën e qetësisë e sigurisë kombëtare.

Duke përfunduar, nënvizojmë se Garda do jetë gjithnjë e gatshme për të punuar me përkushtim që objektivat e këtij viti të përmbushen edhe më cilësisht deri në fund të tij.

VII. OBJEKTIVA PËR 2023

Garda e përqendron veprimtarinë e saj në realizimin e misionit e objektivave për sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe Ruajtjes së Objekteve të Rëndësishme të Veçantë. Ajo mbështetet në legjislacionin në fuqi, programin Qeverisës 2021-2025, programin e Ministrisë së Brendshme, programin e veprimtarive vjetore dhe planifikimin e detyrave mujore, si dhe zbaton praktikën e punës për secilin sektor.

Plani vjetor i Gardës së Republikës përcakton prioritetet kryesore të Gardës për vitin. Dokumentet në zbatim të planit të saj të veprimtarive detajojnë punët që do të kryhen gjatë vitit, duke përshkruar punët rutinë dhe ato të reja të planifikuara në kuadër të përmbushjes së misionit, gjithmonë me qëllim përafrimin e standardeve me ato të BE.

Prioriteti kryesor është dhe do të vijojë të jetë edhe për vitin 2023 *siguria e jetës së personaliteteve*, si dhe objekteve e mjediseve të punës, të banimit, të akomodimit, shoqërimit e sigurisë në rrugëkalime, në shërbime të hapura e të mbyllura me qëllimin që të prandalohet në kohë jo vetëm çdo akt i mundshëm me tendencë kriminale, por edhe çdo veprim tjetër sado i dhunshëm apo pengues në lëvizjen normale dhe ushtrimin e detyrës së personalitetit.

Për vitin 2023 Garda synon të rrisë efikasitetin e saj në disa drejtime kryesore. Për këtë qëllim janë hartuar dhe synohen të përmbushen objektiva të mirëorganizuar nga çdo strukturë, pjesë përbërëse e Institucionit.

Objektiva:

- a) rritja e nivelit të sigurisë nëpërmjet shtimit të trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional në këtë drejtim por edhe duke përmirësuar teknologjinë;

- b) përmirësimi i procesit të menaxhimit në Gardë nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve në fushën e lidershipit;
- c) përmirësimi i performancës së strukturave operationale dhe atyre mbështetëse nëpërmjet shtimit të kontroleve dhe përmirësimit të elementeve që dobësojnë këto struktura;
- d) përmirësimi i programeve trajnuese në Gardë;
- e) forcimi i integritetit duke implementuar dhe monitoruar dokumentin strategjik të miratuar për këtë qëllim që është “Plani i Integritetit i Gardës së Republikës”;
- f) finalizimi i plotësimit të kuadrit ligjor të Gardës së Republikës.

Po ashtu, në varësi të agjendës shtetërore, do të merren masat e sigurisë për aktivitetet e planifikuara dhe ato të paparashikuara. Një event tjetër i rëndësishëm që pritet të mbahet është Samiti i Berlinit në Tiranë, apo edhe zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Gjatë vitit 2023 do të implementohet në çdo strukturë organika e re e miratuar me Urdhër nr. 252, datë 30.12.2022 të Ministrisë të Brendshme e do të fillojnë masat e sigurisë për objektin e SPAK dhe GJKKO.

Projekt-Aktet që pritet të miratohen në vitin 2023:

Nr.	Titulli i projekt-aktit	Lloji i projekt-aktit
1.	“Për përcaktimin e procedurave të trajtimit me ushqim gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës”	P/VKM
2.	“Për përcaktimin e kohëzgjatjes e mbrojtjes së personaliteteve të tjera pas lënies së detyrës dhe kohëzgjatjes së ruajtjes së banesës së personaliteteve të tjera”	P/VKM
3.	“Për përcaktimin e masës ditore të përfitimit dhe procedurën e kompensimit për strehim për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë”	P/VKM
4.	“Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për transferimin e punonjësve në struktura të tjera me gradë”	P/VKM
5.	“Për trajtimin e punonjësit me ndihmë financiare në rastet e fatkeqësive në familje, trajtimin e punonjësit me ndihmë financiare në masën e tri pagave mujore, trajtimin e punonjësit me ndihmë të menjëhershme financiare në rast të dëmtimit të rëndë të pronës private për shkak të detyrës”	P/VKM
6.	“Për sigurimin shëndetësor të veçantë, të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë”	P/VKM
7.	“Për trajtimin me kredi të butë të punonjësve të Gardës së Republikës së Shqipërisë”	P/VKM